



Norwegian Embassy



RAPORT PËR STANDARDIN E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI 2021



Ky studim u hartua si pjesë e projektit “Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri”, zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në partneritet me Avokatin e Popullit dhe me mbështetjen financiare të Ambasadës Norvegjeze.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara apo donatorit të tij.

Punoi: Arjana Fullani
Dritan Shano
Marinela Sota

© Të gjitha të drejtat të rezervuara

UNDP Albania

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| Përmbledhje ekzekutive | 4 |
| 1. Hyrje | 8 |
| 1.1 Objektiva | 8 |
| 1.2 Metodologjia | 9 |
| 2. Minimum jetik në perspektivën ligjore | 11 |
| 2.1 Vështrim i Përgjithshëm | 11 |
| 2.2 Kuadri rregullator i brendshëm dhe nismat e ndërmara për caktimin e minimumit jetik | 15 |
| 2.3 Roli i institucioneve publike në kuadër të përcaktimit të minimumit jetik dhe obligimet e tyre në këtë drejtim | 20 |
| 2.4 Jurispudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut | 23 |
| 2.5 Praktika nga vende të tjera dhe qasja e tyre ndaj konceptit të minimumit jetik | 24 |
| 2.6 Problematika të zbatueshmërisë | 28 |
| 2.7 Përfundime dhe rekomandime | 29 |
| 3. Minimumi jetik, mbrojtja sociale dhe varfëria në Shqipëri | 31 |
| 3.1 Politikat sociale ekzistuese për mbrojtjen sociale dhe minimumi jetik | 31 |
| 3.1.1 Politikat sociale për mbrojtjen sociale | 31 |
| 3.1.2 Situata aktuale e varfërisë në Shqipëri dhe efektiviteti i politikës së NE-së | 33 |
| 3.1.3 Arritje dhe sfida | 34 |
| 3.1.4 Minimumi jetik | 36 |
| 3.2 Politikat e suksesshme të mbrojtjes sociale të lidhura me minimumin jetik në Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor | 37 |
| 3.2.1 Rasti i Kroacisë | 39 |
| 3.2.2 Rasti i Maqedonisë së Veriut | 40 |
| 3.3 Përfundime dhe rekomandime | 40 |
| 4. Minimumi jetik në perspektivën ekonomike | 42 |
| 4.1 Kuadri ekonomik dhe minimumi jetik | 42 |
| 4.2 Politikat sociale dhe Minimumi Jetik në vendet e Bashkimit Europian | 43 |
| 4.3 Minimumi Jetik në vendet e Bashkimit Europian | 45 |
| 4.4 Minimumi Jetik në vendet e Ballkanit Perëndimor | 49 |
| 4.5 Përlllogaritja e minimumit jetik | 51 |
| 4.6 Përfundime dhe Rekomandime | 55 |
| 4.7 Përfundime dhe rekomandime | 55 |
| 5. Aneks | 55 |

Përmbledhje ekzekutive

Një nga parimet e Axfordës së Kombeve të Bashkuara 2030 është progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë individëve dhe familjeve të varfëra. Qeveria shqiptare, në këtë kuadër dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, ka nisur një reformë të sistemit të mbrojtjes shoqërore duke investuar në hartimin e një legjislacioni të ri në këtë fushë dhe ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem efektiv të mbrojtjes sociale.

Të dhënat tregojnë që megjithëse varfëria relative ka ardhur në ulje të pakonsiderueshme nga 23.7 (në vitet 2017-2018¹) në 23.4 në vitin 2018, përqindja e popullatës që janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta është 49%², që do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.

Megjithëse masa e pagesës së Ndhmës Ekonomike vazhdon të jetë më e ulëta në Evropë dhe në rajon, ka një tregues pozitiv sa i përket ndikimit sado të vogël që kjo transfertë ka mbi individët dhe familjet e varfëra që përfitojnë nga kjo politikë për vitet 2017-2018³, që do të thotë se kjo politikë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë për zbutjen e varfërisë dhe duhet përmirësuar për të siguruar rezultatin e synuar.

Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një vlerësim të situatës ekonomike, ligjore dhe sociale sa i përket situatës së mospërcaktimit të minimumit jetik si përkufizim dhe si bazë jo vetëm për Ndhmën Ekonomike, por edhe për politikën e tjera në mbështetje të individëve dhe familjeve të varfëra në Shqipëri.

Objektivat e studimit janë: i) të bëjë një panoramë aktuale të situatës ekonomike dhe të varfërisë në Shqipëri dhe të projektojë një nivel të minimumit jetik; ii) të eksplorojë zhvillimet e legjislacionit në Shqipëri sa i përket mbrojtjes sociale dhe të vlerësojë nëse këto zhvillime përputhen me parimin e “jetës me dinjitet” apo me objektivin për zhdukjen e varfërisë⁴; iii) të analizojë politikën aktuale për ndihmën ekonomike dhe ndikimin e saj në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin e grupeve të cënueshme; iv) të ofrojë rekomandime për përmirësimin e ndikimit të NE në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin e përfituesve të NE.

1 UN Country Report for Albania, 2020.

2 Po aty

3 Po aty

4 Objektivi nr.1 i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm <https://sdgs.un.org/goals>

Gjetjet kryesore

Nga analiza e legjislacionit shqiptar në tërësi rezulton se minimumi jetik është një normë ligjore që buron nga të drejtat kushtetuese të qytetarëve. Edhe pse koncepti i minimumit jetik është i parashikuar prej më tepër se 2 dekadash si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave, kryesisht të punëmarrësve, mungojnë aktet nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik dhe përshtatjen e kësaj mase në planin kohor.

Kjo mangësi shërben si një premisë për standarde të dyfishta në mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve në lidhje me garancitë që ofron legjislacioni përsa i përket minimumit jetik. Fusha praktike ku haset më së shumti kjo mangësi është fusha e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve monetare mbi pagat e punëmarrësve me të ardhura të ulta. Proceset ekzekutive mund të shkaktojnë rënien e kategorive të tilla të punëmarrësve në varfëri të skajshme nëse paga e tyre nuk mbrohet nga një minimum i paprekshëm.

Megjithë përpjekjet e qeverisë shqiptare për të reformuar sistemin e mbrojtjes sociale, mungon përkufizimi i minimumit jetik në legjislacionin për mbrojtjen sociale, gjë që ndikon në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre⁵.

Sipas vlerësimeve të deritanishme, masa e NE-së nuk ka pësuar rritje pas reformës. Masa e NE nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për ushqimin por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor për individët dhe familjet kur ata kanë nevojë.

Fëmijët dhe familjet e mëdha janë më të varfërat dhe grupet më të rrezikuara për të rënë në varfëri. Megjithë vëmendjen e rritur dhe ndryshimin e masës së NE për këto grupe, ky ndryshim ka qënë minimal dhe pa ndikim për daljen e tyre nga varfëria.

Kategorizimi, që bëhet për individët dhe familjet që mund të përfitojnë NE, në legjislacionin për NE dhe përfitimin e saj është shumë i detajuar dhe i komplikuar duke krijuar mundësi që individë apo familje të caktuara të mos përfitojnë nga skema.

Investimi në politika të tjera, si politika e arsimit, shëndetit apo punësimit që konsiderohen si politikat që ndikojnë më shumë në zbutjen e varfërisë dhe daljen nga varfëria, nuk ka ardhur në rritje, përkundrazi është më i ulëti në rajon.

Bazuar në analizën e kryer në interes të këtij raporti, nxjerrim përfundimin se vlera e minimumit jetik për vitin 2019 në Shqipëri është përafërsisht **17, 875 Leke**.

Vlera e përlogaritur në këtë studim të minimumit jetik në Shqipëri është 9,9 % më e lartë sesa pensioni minimal për zonat urbane, 37,5 % më e lartë se pagesa e papunësisë dhe rreth 3 herë më e lartë se ndihma ekonomike, ndërsa është 45,5 % më e ulët sesa paga minimale.

⁵ Një nga masat pozitive të marra nga qeveria shqiptare për përbalimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore si pasojë e përhapjes së sëmundjes infektive COVID ishte dyfishimi i pagesës për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike apo pagesës për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

Rekomandimet

Është e rëndësishme që vakumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik duhet të përfundojë sa më parë në mënyrë që të vendoset një standard normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike, si dhe të sigurohen garancitë e qytetarëve në drejtim të sigurimit të mjeteve të tyre të jetesës. Minimumi Jetik duhet të sigurojë jetesë dinjitoze me shërbimet bazike dhe duhet t'u mundësojë të gjithë shtetasve që të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar. Minimumi jetik duhet të bëhet një pjesë kryesore e sistemit kombëtar të mbrojtjes shoqërore dhe shëndetësore. Raporti sugjeron ndryshimin e Ligji Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshirjen e përkufizimit të minimumit jetik si dispozitë të veçantë.

Legjislacioni duhet të parashikojë format dhe mjetet se si duhet të zbatohet e drejta për të përfituar nga ky minimum deri sa të mundësojë që çdo qytetar të përfitojë lehtësisht një garanci të tillë dhe mos mjaftohet vetëm me përcaktimin e vlerës shifrore të këtij koncepti.

Në formulimin e minimumit jetik të merret në konsideratë dhe të vlerësohet drejt objektivi i sigurimit të mirëqenies së individit në përputhje me konceptin e dinjitetit njerëzor të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, në mënyrë të tillë që individit, përpos një jete dinjitoze, t'i mundësohet akses të paktën minimal në jetën kulturore, sociale dhe politike.

Përlllogaritja e minimumit jetik dhe masa e tij duhet të jetë bazë për masën e NE dhe pagesën për Aftësinë e Kufizuar. Rritja e pagesës së NE është e nevojshme të bëhet dhe të reflektojë nevojat e individëve dhe familjeve jo vetëm për ushqim por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor.

Të thjeshtëzohet mekanizmi i kategorizimit të të ardhurave të individëve dhe familjeve që mund të përfitojnë nga skema e NE duke synuar mospërrjashtimin e kategorive apo nënkategorive.

Të hartohet dhe miratohet metodologjia për llogaritjen e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë, që të shërbejë si udhërrëfyes dhe referencë zyrtare për llogaritjen periodike të Minimumit Jetik. Kjo metodologji dhe institucionet që do caktohen për ta hartuar atë duhet të mbajë parasysh, por jo të kufizohet: Parimet bazë të mbulimit me mjete financiare; Qasje të përbashkëta, të integruara dhe unike ndaj minimumit jetik; Përcaktojë kërkesat e përbashkëta për informacion për të adresuar nevojat e grupeve në nevojë.

Minimumi jetik të përdoret në themel të hartimit të Politikave Sociale për shtetas në nevojë. Minimumi jetik të përdoret si referencë për të përcaktuar pensionin minimal urban dhe rural, pagën minimale, ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë

Shkurtime

| | |
|---------------|--|
| NE | Ndihma Ekonomike |
| SMS 2015-2020 | Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 |
| BP | Ballkani Perëndimor |
| UN | Kombet e Bashkuara |
| UNDP | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| UNICEF | Zyra e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| KEDNJ | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut |

Hyrje

1.1 Objektivat

Një nga parimet e Axhendës së Kombeve të Bashkuara 2030 është progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë individëve dhe familjeve të varfëra. Qeveria shqiptare, në këtë kuadër dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, ka nisur një reformë të sistemit të mbrojtjes shoqërore duke investuar në hartimin e një legjislacioni të ri në këtë fushë dhe ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem efektiv të mbrojtjes sociale.

Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një vlerësim të situatës ekonomike, ligjore dhe sociale sa i përket situatës së mospërcaktimit të minimumit jetik si përkufizim dhe si bazë jo vetëm për Ndihmën Ekonomike, por edhe për politikën e tjera në mbështetje të individëve dhe familjeve të varfëra në Shqipëri. Nevoja për këtë raport është aktuale, sidomos në kushtet e një reforme të thellë në sistemin e mbrojtjes sociale që Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë. Bazuar në gjetjet e raportit, do të ofrohen rekomandime për ndryshimin apo përmirësimin e politikës së Ndihmës Ekonomike, bazuar në nivelin e minimumit jetik.

Më konkretisht, raporti përqëndrohet në këto çështje kryesore:

- i) Paraqitjen e një panorame aktuale të situatës ekonomike dhe të varfërisë në Shqipëri dhe projektimin e një niveli të minimumit jetik;
- ii) Eksplorimin e zhvillimeve të legjislacionit në Shqipëri sa i përket mbrojtjes sociale dhe vlerësimin nëse këto zhvillime përputhen me parimin e jetës dinjitoze;
- iii) Analizën e politikave aktuale për ndihmën ekonomike dhe ndikimin tyre në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin e grupeve të cënueshme;
- iv) Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e ndikimit të NE në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin e përfituesve të NE.

1.2 Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë raport konsiston në:

- i) Shqyrtimi i dokumentave politikë dhe ligjorë për mbrojtjen sociale dhe veçanërisht NE. Për më shumë, eksplorimi i studimeve, raporteve, literaturës akademike për sistemet e mbrojtjes sociale në Evropë, Ballkanin Perëndimor dhe në Shqipëri. Analiza ligjore përfshiu edhe shqyrtimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut (Strasburg) për çështjet e interesit vendas dhe disa praktika të Gjykatave Kushtetuese në nivel Evropian.
- ii) Analizë sasiore e të dhënave⁶ të disponueshme nga bazat e të dhënave. Metoda e përdorur në këtë studim për të llogaritur Minimumin Jetik në Shqipëri është ajo e njohur si Metoda e Varfërisë Absolute. Sipas kësaj metode janë llogaritur: kufiri i varfërisë ushqimore dhe kufiri i varfërisë jo-ushqimore. Të dy këto kufij varfërie u llogariten si kosto të nevojave bazike ushqimore dhe jo-ushqimore. Mbledhja e vlerave monetare të këtyre dy kufijve të varfërisë na jep Minimumin Jetik.
- iii) Intervista me studiues të politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri, të cilët mund të japin një perspektivë historike të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri dhe vlerësim të efektivitetit të tyre (lista e tyre është përfshirë në anekset e raportit).

Kufizimet e studimit

Së pari, në kushtet kur skema e re e NE është zbatuar në nivel kombëtar vetëm në vitin 2018, është e vështirë për të pasur një vlerësim të efektivitetit të saj, gjë që do të bëhet e plotë vetëm pas disa viteve.

Së dyti, përdorimi i nivelit të të ardhurave për të përcaktuar NE bëhet në Shqipëri vetëm prej vitit 2018 (më parë përdorej niveli i konsumit) sjell vështirësi në vlerësimin ekonomik të nevojave të individëve dhe familjeve në raport me masën e ndihmës ekonomike.

Së treti, për përllogaritjen e minimumit jetik është përdorur metoda e varfërisë absolute, ose matja e nevojave minimale për të patur një jetë të shëndetshme, sipas të cilës ky minimum përllogaritet duke përcaktuar nevojat minimale të një shporte ushqimesh, mallrash dhe shërbimesh. Kjo metodë përdoret gjerësisht në vendet në zhvillim dhe jo vetëm⁷; aty ku të ardhurat janë në nivele të ulëta dhe të mesme preferohet një kufi varfërie absolute për të përkufizuar dimensionin e nevojës për të garantuar minimumin jetik. Në vendet e pasura, informacioni i përfutur përmes llogaritjes së minimumit jetik me metodën e varfërisë absolute nuk përcjell informacionin e duhur ndaj përdoret metoda e varfërisë relative. Avantazhe të tjera të metodës së varfërisë absolute për përllogaritjen e minimumit jetik janë se ajo mundëson matjen e qartë të varfërisë në çdo kohë, duke e bërë këtë matje të krahasueshme edhe me vende të tjera pasi përdoren standarde të ngjashme.

⁶ Të dhënat në këtë raport përfshijnë periudhën deri në Korrik 2021.

⁷ Nga vendet e zhvilluara edhe Kanadaja përdor metodën e varfërisë absolute për llogaritjen e minimumit jetik. Ndërsa vendet e OECD përdorin metodën e varfërisë relative.

Kufizimet e kësaj metode të përlogaritjes së minimumit jetik lidhen me dinamikat e zhvillimit që çojnë në ndryshimin e përcaktimit të minimumit jetik, pra vështirësojnë ndërtimin e një kufiri të varfërisë absolute në kohë, më vështirësinë për përcaktimin e kalorive të nevojshme bazike përkundrejt metabolizmit dhe nivelit të aktivitetit të individëve të ndryshëm, dhe me vështirësinë e përcaktimit të kostove dhe nevojave të ekzistencës.

Megjithatë, raporti duke përdorur një strategji kërkimi dhe metodologji të përzier, sjell gjetje të cilat janë të rëndësishme dhe mund të përdoren për përmirësimin e politikave në fushën e mbrojtjes sociale. Avokati i Popullit e konsideron të nevojshëm përgatitjen e tij në kuadër të promovimit të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.

2. Minimumi jetik në perspektivën juridike

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Koncepti i minimumit jetik e ka origjinën në studimet mbi mendimin ekonomik që në periudhën e lashtësisë greke, ndërsa që nga fillimet e mendimit të ekonomisë politike,⁸ ky koncept është bërë objekt i studimit të shkencave të ndryshme sikurse janë ekonomia, filozofia, shkencat sociale, shkencat politike dhe ato juridike. Më së shumti, koncepti i minimumit jetik i është referuar *një page të nevojshme për të mundësuar mbijetesën bazuar në një kosto reale jetese*.⁹ Megjithatë, prej viteve '90 janë bërë përpjekje për të zgjeruar konceptin e minimumit jetik duke përfshirë në të *parametrat e një jetese dinjitoze*, sikurse është edhe mundësia për të mbuluar nevojat e familjes, të ruajtjes së ndjenjës së vetrespektit ndaj jetës, dhe mundësisë për të marrë pjesë lirisht në jetën sociale e kulturore të vendit përkatës.¹⁰

Debati mbi pagën minimale në Shqipëri, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe lidhja e saj me minimumin jetik, sikurse është parashikuar në disa ligje, është një debat që kapërcen fushën e politikave sociale dhe atyre të punësimit duke prekur çështje të natyrës makroekonomike dhe kushtetuese. Ndër-disiplinariteti i çështjes duhet të identifikohet dhe studiohet sa më drejt në mënyrë që të arrihet një ekuilibër legjitim i cili maksimizon interesat publike të shoqërisë shqiptare në tërësi, dhe shmang fokusin nga trajtimi i minimumit jetik apo pagës minimale si një barrë për ekonominë dhe buxhetin e shtetit. Kjo, pasi minimumi jetik, më tepër se sa pengesë për zhvillimin ekonomik, duhet parë si një faktor zhvillimi. Për këtë nevojiten qasje konstruktive të cilat të adresojnë maksimalisht polarizimin e thellë të konfliktit ndërmjet rritjes ekonomike dhe politikave sociale të punësimit.

Për të vënë në jetë këtë qasje, kërkohen procese legjislative të cilat respektojnë dhe integrojnë në produktet e tyre kornizën e parimeve normative ligjore dhe kushtetuese të cilat udhëheqin debatin mes argumenteve të lidhura me normën e minimumit jetik. Pyetja e parë që shtrohet në këtë drejtim është nëse minimumi jetik është normë ligjore apo jo? Sikurse do të analizohet në seksionet vijuese, minimumi jetik ka mbi 25 vjet që është integruar në legjislacionin shqiptar si

8 Schulten, Thomas; Müller, Torsten, Living wages – normative und ökonomische Gründe für einen angemessenen Mindestlohn, Artikull I botuar në WSI-Mitteilungen, Tetor 2017, DOI: 10.5771/0342-300X-2017-7-507, https://www.researchgate.net/publication/320491294_Living_Wages_-_normative_und_ökonomische_Gründe_für_einen_angemessenen_Mindestlohn.

9 Fabo, Brian; Belli, Sharon Sarah, *(Un)belivable Wages? An analysis of minimum Wage policies in Europe from a living wage perspective*, IZA Journal of Labor Policy, 2017, ISSN 2193-9004, Springer, Heidelberg, Vol. 6, Iss. 4, fq. 1-11, fq. 3, <http://dx.doi.org/10.1186/s40173-017-0083-3>.

10 *Ibid.*

një parashikim kufizues i mbajtjes së detyrueshme të pagës apo të ardhurave jetike të debitorëve, por pa një përkufizim konkret të këtij termi. Gjithsesi, ai mbetet ende teorik dhe i pa përcaktuar në terma konkretë, duke reflektuar në këtë mënyrë, më tepër se sa dështimin e institucioneve politike të qeverisjes, natyrën e sofistikuar dhe komplekse të tij. Mungesa e këtij definicioni e bën Shqipërinë pjesë të grupit të atyre vendeve që nuk mund të garantojnë apo sigurojnë në mënyrë efektive burimet e jetesës bazë së qytetarëve. Në mënyrë të tërthortë, shmangjet kështu edhe evidentimi i relacionit të minimumit jetik si një koncept bazë me pagën minimale të miratuar në rang vendi. Ky relacion do të nxirrte në pah aftësinë e shoqërisë për të garantuar nëpërmjet ndërhyrjes rregullatore të shtetit (sikurse është paga minimale) mirëqenien e shtresave shoqërore që jetojnë në kufijtë e të ardhurave minimale. Më tepër se sa ballafaqim metodologjish, debati mbi relacionin ndërmjet minimumit jetik dhe pagës minimale duhet të synojë arritjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet një shoqërie solidare e të barabartë dhe modeleve të zhvillimit mbi bazën e parimeve të ekonomisë së tregut. Tek e fundit, minimumi jetik sikurse paga minimale apo ndihma sociale janë instrumente që mund të amortizojnë efektet negative të ekonomisë së tregut për shoqërinë në tërësi. Këto janë shprehje e parimeve kushtetuese që formojnë bazën e shtetit shqiptar, sikurse janë dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore (neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

Norma ligjore e minimumit jetik ka karakteristika të ngjashme me kategori të tjera të parashikuara nga legjislati shqiptar, sikurse janë, “paga e paprekshme”, “paga minimale”, dhe “ndihma ekonomike”. Sikurse do të evidentohet edhe në kapitujt vijues, minimumi jetik parashikohet në nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë (“KPC”) si një kufi i cili nuk duhet të preket nga shërbimi i përmbarimit gjatë ekzekutimit të detyrueshëm ndaj pagës së debitorit. Kjo është një dispozitë blanket, pasi kërkon që përkufizimi i këtij minimumi të bëhet nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- a. Në kushtet e mungesës së akteve të tilla, duke iu referuar burimeve akademike, koncepteve analoge në legjislati të huaja, si dhe jurisprudencës së këtyre vendeve, rezulton e pranuar gjerësisht se minimumi jetik konsiderohet *një pagë e nevojshme për të mundësuar mbijetesën bazuar në një kosto reale jetese, pjesëmarrjen lirisht në jetën sociale e kulturore të vendit përkatës*.¹¹Duhet evidentuar se ky përkufizim i referohet të gjithë qytetarëve pavarësisht nëse ato janë në marrëdhënie pune apo gjenden në kushte pamundësie për të siguruar burimet e jetesës për shkak të papunësisë, paaftësisë fizike apo moshës.
- b. Në dallim nga koncepti i minimumit jetik, *paga e paprekshme* është përkufizuar në nenin 123(1) të Kodit të Punës si një *masë që është e nevojshme për të siguruar jetesën e punëmarrësit dhe të familjes së tij*, është një koncept i cili qëndron i lidhur ngushtë me marrëdhënien juridike të punës, dhe si i tillë gjen zbatim kryesisht në raste individuale në procese gjyqësore kur merret në shqyrtim ulja e pagës së punëmarrësit nga ana e punëdhënësit sipas nenit 122 të Kodit të Punës në kuadër të zbatimit të vendimeve gjyqësore apo shpërbërimit të dëmeve të shkaktuara me qëllim nga punëmarrësi.
- c. Paga minimale është sërish një kategori që buron nga Kodi i Punës e cila gjen një zbatim të gjerë në ekonomi. Neni 111 i këtij Kodi parashikon se *paga nuk mund të*

11 Fabo, Brian; Belli, SharonSarah, *(Un)belivableWages? An analysis of minimum Wagepolicies in Evrope from a livingwageperspective*, IZA JournalofLaborPolicy, 2017, ISSN 2193-9004, Springer, Heidelberg, Vol. 6, Iss. 4, fq. 1-11, fq. 3, <http://dx.doi.org/10.1186/s40173-017-0083-3>.

jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo pagë përcaktohet periodikisht në bazë të faktorëve ekonomikë, kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë, rritjes së prodhimit, nevojave të punëmarrësve dhe familjeve të tyre, nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore.

- d. Së fundmi, kategoria tjetër e cila shpesh herë nxit debatin apo edhe frenon procesin e artikullimit të minimumit jetik në planin normativ, është ndihma ekonomike, e cila përkufizohet si *mbështetja në para që i jepet familjeve dhe individëve në nevojë* (neni 4(k) i Ligjit 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”). Shqipëria, duke qenë një vend me tregues ekonomikë të ulët dhe papunësi relativisht të lartë, mban një barrë të lartë buxhetore në drejtim të mbështetjes ndaj shtresave në nevojë. Është fakt që ndihma ekonomike është mbi 3 herë më e ulët se niveli i pagës minimale të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Nga kjo mund të provohet se ndihma ekonomike nuk duhet kuptuar si një “pagë” e mirëfilltë që zëvendëson pagën nga punësimi, por si një mbështetje për familjet në nevojë. Në rast se Shqipëria do të kishte të miratuar një minimum jetik si një tregues normativ, ai do të shërbente si një matës i treguesve të tjerë ekonomikë dhe socialë sikurse janë paga minimale dhe ndihma ekonomike. Për të shmangur presionet politike ndaj buxhetit, miratimi i minimumit jetik ka mbetur në heshtje dekadat e fundit, nëse nuk do të merren në konsideratë disa masa të mbetura në fazat embrionale që do të trajtohen në vijim.

Si konkluzion i analizës krahasimore mes këtyre komponentëve, është e rëndësishme që vakumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik duhet të përfundojë sa më parë në mënyrë që të vendoset një standard normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike, si dhe të sigurohen garancitë e qytetarëve në drejtim të sigurimit të mjeteve të tyre të jetesës. Duke qenë se Shqipëria është në proces përafrimi legjislativ me BE, mund të konsiderohet edhe mundësia e huazimit të standardit nga vendet e BE. Integrimi si paradigmë zhvillimi është një koncept i kristalizuar jo vetëm në politikën legjislativë shqiptare, por edhe pjesë thelbësore e zhvillimit shoqëror në tërësi. (Megjithatë, në rastin e minimumit jetik, është e nevojshme të analizohet dhe të gjendet “zgjidhja shqiptare” e problemit duke qenë se çështjet e politikave sociale të punësimit nuk janë të integruara në nivel evropian.) Në kuadrin e nevojës së ndërtimit të një shtylle evropiane të të drejtave sociale, ka përpjekje që shtetet evropiane, me gjithë diferencat e tyre, të garantojnë një nivel të caktuar dinjiteti mes qytetarëve.¹² Konkretisht, së fundmi ka pasur disa iniciativa konkrete nga Bashkimi Evropian kundrejt forcimit dhe modernizimit të sistemeve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Në muajin Tetor të vitit 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi konkluzionet lidhur me forcimin e garantimit të të ardhurave minimale për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror gjatë pandemisë COVID-19, dhe pas saj¹³. Nëpërmjet këtij dokumenti, Këshilli fton Komisionin të fillojë përditësimin e kuadrit ligjor të BE, me qëllim mbështetjen efektive dhe plotësimin e mëtejshëm të politikave të shteteve anëtare lidhur me të ardhurat minimale në nivel kombëtar (në vendet e BE). Në majin Mars

12 *Ibid.*, fq. 1. Autorët i referohen qëndrimit të Presidentit të Komisionit të BE Jean-Claude Juncker të shpalosur në fjalimin e tij mbi Gjendjen e Bashkimit për vitin 2016 të mbajtur në Janar 2017.

13 Council of the European Union - Strengthening Minimum Income Protection to Combat Poverty and Social Exclusion in the COVID-19 Pandemic and Beyond, Council Conclusions (9 October 2020) link: <https://www.consilium.europa.eu/media/46078/11721-re02-en20.pdf>

të vitit 2021 Komisioni Evropian prezantoi *Planin e Veprimit lidhur me të drejtat Sociale*¹⁴. Ky plan veprimi parashikon adoptimin e një rekomandimi të Këshillit të BE lidhur me të ardhurat minimale në vitin 2022, duke theksuar se kushdo me të ardhura të pamjaftueshme ka të drejtën e të ardhurave minimale për të garantuar një jetë me dinjitet. Gjithashtu, aktualisht (prill 2021) Bashkimi Evropian është në fazën e konsultimit publik (me institucionet e BE si dhe shtetet anëtare), të propozimit për nismën legjislative lidhur me miratimin e një Direktive mbi pagën minimale në Bashkimin Evropian¹⁵. Ky propozim i cili është publikuar për herë të parë në muajin tetor të vitit 2020 ka për synim që të garantojë se të gjithë qytetarët që punojnë në Bashkimin Evropian të kenë të ardhura të mjaftueshme që garantojnë një jetesën me dinjitet, duke mbajtur në konsideratë se kur të ardhurat minimale caktohen në nivelet e duhura, ato sjellin efekte pozitive jo vetëm në aspektin shoqëror, por edhe përfitime ekonomike.

Ndërmjet divergjencave mes shteteve të ndryshme evropiane, është e rëndësishme të identifikohen argumentet normative dhe ekonomike për të evidentuar rrugën më efektive për një shoqëri drejt ekuilibrit mes pagës minimale dhe minimumit jetik. Një nga parimet thelbësore, i cili sikurse do të analizohet në seksionet vijues është pjesë e legjislacionit shqiptar, është që minimumi jetik duhet të konsiderohet një barrierë për të garantuar një “vlerë minimale absolute të nevojshme për një jetesë dinjitoze”. Ky parim kapërcen kuptimin dhe interpretimin literal që i është bërë konceptit ndër vite si një pagë minimale për të garantuar mbijetesën. Më tepër se sa kufijtë e mbijetesës, për një shoqëri është e rëndësishme jetesa dinjitoze. Krahas argumentit të John Rawls që nën konceptin e “drejtësisë së paanshme” shikon si të tillë vetëm kur pabarazitë janë të pranueshme për aq kohë sa nuk dëmtojnë më të dobëtit në shoqëri, vlejnë edhe argumentet se të mundësosh një jetesë dinjitoze për punonjësit me të ardhura të ulta, do të thotë të kontribuosh në stabilitetin makroekonomik, fuqizimin e kërkesës në treg, si dhe rritjen e cilësisë së punësimit dhe produktivitetit, dhe uljen e ndikimeve negative ndaj sistemit fiskal. Gjithashtu, në këtë mënyrë shmangen edhe rreziqet që pabarazia mund të sjellë për sistemin demokratik të qeverisjes.¹⁶

Nëpërmjet aderimit në instrumentat ndërkombëtarë për të drejtat ekonomike dhe sociale si Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale apo Karta Sociale Evropiane shtetet marrin përsipër një detyrim të trefishtë për të respektuar, mbrojtur dhe garantuar të drejtat ekonomike dhe sociale. (1) Respektimi lidhet me mosndërhyrjen e shtetit në gëzimin lirisht të të drejtave sociale ekonomike dhe kulturore; (2) mbrojtja lidhet me parandalimin e cënimit të këtyre të të drejtave nga palë të treta ndërsa (3) garantimi lidhet me adaptimin e masave të nevojshme legjislative, administrative apo buxhetore për të lehtësuar aksesin në këto të drejta, për t'i promovuar ato si dhe për të ofruar mundësinë e realizimit të këtyre të drejtave në rastet kur individët për arsye të cilat nuk varen nga vullneti i tyre, nuk mund t'i realizojnë ato. Kështu, shtetet marrin përsipër detyrimin për të garantuar plotësimin e niveleve minimale jetike të të drejtave, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tyre ekonomik. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare, nëse shteti nuk është në gjendje të vërtetojë se është bërë çdo përpjekje për të përdorur të gjithë burimet që ka në dispozicion për të prioritarizuar arritjen e niveleve minimale që garantojnë një jetë me dinjitet për këdo.

14 The European Pillar of Social Rights Action Plan, link: <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=23696&langId=en>

15 EU Commission Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council on adequate minimum wages in the European Union, link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020PC0682&from=EN>

16 *Ibid*, fq. 3

2.2 Kuadri rregullator i brendshëm dhe nismat e ndërmarra për caktimin e minimumit jetik

Minimumi jetik është një garanci për qytetarët për të siguruar mjetet e nevojshme të një jetese dinjitoze. Minimumi jetik përbën kostot bazë për shpenzimet minimale jetike mujore: ushqimore (ushqimet, pijet jo-alkoolike, mallra e shërbime të këtij konteksti, që përbëjnë rreth 45 % të këtyre shpenzimeve) dhe ato jo-ushqimore (shpenzimet për banesën, ujin, energjinë elektrike, qiranë, mobilimin, mirëmbajtja e zakonshme e banesës, veshmbathja, shëndeti, transporti, komunikimi, arsimimi etj. shërbime e shpenzime të këtij konteksti, që përbëjnë rreth 55 % të këtyre shpenzimeve). Kjo garanci nuk gjen referenca konkrete në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë por qëndron si parim në frymën e Kushtetutës tonë. Në kreun IV të Kushtetutës ku trajtohen liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, paraqitet e drejta për të zgjedhur punë të ligjshme dhe e drejta e mbrojtjes shoqërore në punë, por nuk përcakton një garanci minimale për të punësuarit në lidhje me të ardhurat nga punësimi apo për të papunët. Gjithashtu, neni 52 i Kushtetutës parashikon që kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, ose kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe mbetet pa mjetet të tjera jetese, por për kushtet e dhënies së kësaj ndihme kjo dispozitë kushtetuese referon në sisteme të caktuara me ligj. Kjo do të thotë që minimumi jetik është një koncept i paparashikuar në Kushtetutë, teksa dhe trajtimi i tij në nivel ligjor gjen mungesë aplikimi. Deri më sot minimumi jetik përkufizohet në legjisllacionin e brendshëm në mënyrë të përgjithshme, shpeshherë tërthorazi dhe i parregulluar, sikurse do të shpjegojmë në vijim.

Me miratimin e Kodit të Punës në vitin 1995, në Nenin 123 parashikohej se ministria që mbulon çështjet e punës ishte përgjegjëse për përcaktimin e minimumit jetik së bashku me strukturat e autorizuar prej Ministrisë për përllogaritjen e tij. Por, pas ndryshimeve që i janë bërë Kodit të Punës në vitet e ardhshme, kjo dispozitë është shfuqizuar duke çliruar në këtë mënyrë qeverinë nga detyrimi ligjor për llogaritjen dhe përcaktimin e minimumit jetik si një standard ligjor¹⁷. Sipas kërkimeve nuk rezultoi që ministria e cila mbulonte çështjet e punës, të ketë ndërmarrë nisma ligjore konkrete e të suksesshme për të bërë përcaktimin e minimumit jetik sipas detyrimit ligjor të referuar më sipër (përveç disa hapave pas vitit 2016). Ndaj dhe ky “kapitull” është quajtur i mbyllur me shfuqizimin e referimit që Neni 123 bënte tek minimumi jetik. Në fakt, paracaktimi i këtij koncepti në Kodin e Punës krijon dhe paragjykimin se ky tipar prek vetëm marrëdhënien e punës, teksa kjo nuk i afrohet pritshmërisë që minimumi jetik kërkon të arrijë, duke u ngritur në nivel ligjor.

Sipas Kodit të Punës që është në fuqi, trajtohet koncepti i pagës minimale dhe i pagës së paprekshme. Sipas nenit 111 të Kodit të Punës, paga minimale përcaktohet periodikisht nga Këshilli i Ministrave në bazë të faktorëve ekonomikë, kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë, rritjes së prodhimit, nevojave të punëmarrësve dhe familjeve të tyre, nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet

17 Ligji nr. 9125, datë 29.7.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”

shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale është miratuar në masën 30,000 lekë. Kjo pagë shërben edhe për llogaritjen dhe pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor.

Paga e paprekshme, sipas nenit 123 të Kodit të Punës sot, konsiderohet në masën që është e nevojshme për të siguruar jetesën e punëmarrësit dhe të familjes së tij. Për të përcaktuar këtë, merren parasysh shpenzimet e nevojshme për ushqim, qira, veshje, si edhe detyrimet fiskale ose kontributet për sigurime shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit dhe të familjes së tij. Në dukje, koncepti i pagës së paprekshme është mjaft i afërt me minimumin jetik sepse neni 123 i Kodit të Punës e lidh këtë me shpenzimet e nevojshme për ushqim, qira, veshje, etj. Por, neni 123 i Kodit të Punës parashikon se paga e paprekshme do të jetë e përcaktuar individualisht për çdo rast nga gjykata, në bazë të një çështje konkrete për zgjidhje gjyqësore. Me këtë kuptojmë, se paga e paprekshme sipas legjislacionit në fuqi nuk është një vlerë e përgjithshme, por individuale për çdo person, në varësi të kushteve të tij personale. Kjo ndasi e bën të dallueshëm pagën e paprekshme me minimumin jetik, teksa e para ngelet një vlerësim subjektiv dhe individual i cili derivon nga paga e një individi dhe e dyta një vlerësim më objektiv që merr parasysh faktorët social ekonomik kombëtar ose vendor dhe është i njëjtë për këdo pavarësisht pagës së individëve apo mungesës totale të saj, konsideruar si një vijë e kuqe për të mos e tejkaluar, si një limit varfërie ekstreme. Si rrjedhojë, ndryshimi i nenit 123 (po i njëjti nen i cili referonte më parë minimumin jetik) nga koncepti i minimumit jetik, në atë të pagës së paprekshme, jep idenë e një tentative nga ligjvënësi për të zëvendësuar konceptet me njëri tjetrin, për sa i përket pagës që buron nga marrëdhënia e punës, por nga sa parashtruar, këto terma kanë shumë ndryshime konceptuale mes tyre dhe nuk mund të jenë të barazvlefshëm.

Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” apo aktet nënligjore në zbatim të tij kanë për qëllim të përcaktojnë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, por në të nuk ka një referencë për atë se çfarë konsiderohet nevojë bazë jetike. Sipas ligjit të sipërpërmendur, gjendja e varfërisë për pranueshmërinë në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet një formule të pikëzuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Megjithatë, deri më sot, Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë një akt nënligjor të tillë në bazë të ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Në këto rrethana, meqenëse neni 31 i ligjit nr.57/2019 parashikon se aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, atëherë institucionet përgjegjëse, për të llogaritur gjendjen e varfërisë për pranueshmërinë në skemën ekonomike, duhet t’i referohen Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, i cili ka dalë në zbatim të ligjit të shfuqizuar. Sipas VKM-së Nr.956/2016, formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur me të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtorja, trashëgimia dhe dhuratat.

Pensioni si çështje në këtë diskutim, duhet po ashtu të sigurojë nevojat bazë të jetesës. Ndërkohë në nenin 5/1 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) Jepet përkufizimi i Pensioni social, “*Pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm*

në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.” Ky pension i cili synon mbrojtjen sociale të shtresës së tretë që nuk përfiton nga skema e pensioneve të tjera, përllogaritet me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruara me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. As në rastin e specifikave të pensionit social dhe as të pensionit në tërësi, nuk theksohet në legjisllacion që ky pension duhet të mbulojë një nivel bazë mbijetese (minimumin jetik).

Referenca kryesore e cila citon minimumin jetik në legjisllacionin shqiptar është Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 119, datë 08.03.2001 “Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin “Minimumi Jetik, Zyrtar””. Në këtë VKM jepen detaje të projektit për zbatim nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale të kohës.

Sipas përmbajtjes së projektit të miratuar, për përcaktimin e minimumit jetik me mundësitë që ekzistojnë në Shqipëri, grupi i punës ka konkluduar se mund të përdoren si më të përshtatshme dy metoda:

- Metoda analitike, e cila mbështetet në shportën e minimumit jetik dhe në madhësinë mesatare të çmimeve të artikujve;
- Metoda relative, e cila mbështetet në produktin kombëtar bruto mesatar për frymë.

Sipas këtij studimi do të përcaktohej treguesi i minimumit jetik. Do të përcaktohej struktura e minimumit jetik për artikujt ushqimorë, artikujt e veshmbathjes, pajisje dhe orendi shtëpiake dhe shpenzime të tjera; do të bëhej krahasimi me vende të tjera të Evropës Lindore dhe Perëndimore; do të studiohej papunësia për përcaktimin e koeficientit të ngarkesës për të punësuarit; do të studioheshin të ardhurat reale të popullsisë së qytetit dhe fshatit duke bërë anketime të buxheteve familjare nëpërmjet Institutit të Statistikave.

Sipas rezultateve të pritshme, do miratohej treguesi i minimumit jetik zyrtar në shkallë vendi për vitin 2000. Do të bëheshin sugjerime për përsosjen e kuadrit ligjor në fushën e punësimit, mbrojtjes sociale dhe sigurimit social, si për Kodin e Punës, Ligjin e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Si përfundim, minimumi jetik i llogaritur do të dërgohej në Këshillin e Ministrave, i cili ka të drejtë shpalljen dhe publikimin e tij.

Pavarësisht kësaj, nuk janë evidentuar gjurmë të mëtejshme për hapa të ndjekura dhe propozime të drejtuara në Këshillin e Ministrave që referojnë nisma sipas VKM-së më sipër.

Përcaktimi i treguesit zyrtar të minimumit jetik është i domosdoshëm shpesh edhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës mbi pagën e debitorit. Neni 533 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se, “Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbartuesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Mirëpo, për shkak se nuk ka një referencë të saktë ligjore, janë konstatuar aplikime të ndryshme në lidhje me masën e sekuestros konservative të vendosur mbi pagën e debitorit, e cila duhet të përdoret për shlyerjen e detyrimeve pa cenuar minimumin jetik, sikurse përcaktohet në nenin 533 i Kodit të Procedurës Civile. Le të ndalemi një moment tek problematikat që lidhen me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm nga shërbimi i përmbartimit gjyqësor si një nga rastet ku vëmendja për aplikimin e këtij minimumi është e vazhdueshme dhe thelbësore.

Për zbatimin e kësaj dispozite, subjektet përmbartimore janë ndarë në dy qëndrime:

- Disa subjekte e kanë identifikuar “minimumin jetik” të barabartë me pagën minimale zyrtare të parashikuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Disa subjekte përmbartimore të tjera e kanë trajtuar “minimumin jetik” referuar ndihmës ekonomike sipas Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

Të dyja këto vlerësime janë subjektive dhe ekstreme në vlera, por po ashtu të dyja referojnë vlerësime ligjore të pranueshme në argumentimin e secilës. Në këto rrethana, nga nevoja për unifikim standardi, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, ka nxjerrë Direktivën Nr.46 Prot., datë 19.01.2015 “Për unifikimin dhe zbatimin e Përkohshëm të Masës së Sekuestros Konservative mbi Pagën e Debitorit”, më anë të së cilës kërkon të orientojë të gjithë përmbartuesit gjyqësorë privatë, të cilët gjatë kryerjes së veprimeve ekzekutive mbi të ardhurat e pagës së subjektit-debitor, që të respektojnë “minimumin jetik” në vlerën e pagës minimale sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”. Megjithatë, kjo direktivë është me efekt të përkohshëm deri në përcaktimin e saktë normativ për atë që do përbëjë minimum jetik.

Kjo direktivë e Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, ka përcaktuar dhe dy raste përjashtimore që lidhen me situata të caktuara të cilat po i referojmë në vijim:

1. Detyrimeve ushqimore, pasi nuk mundet që debitori të mos zbatojë një vendim që përmban një detyrim të tillë, duke vendosur se për këto raste duhet të aplikohet një masë sa *gjysma e pagës minimale të sekuestruar*, sikurse edhe,
2. Për rastet kur ndaj debitorit nuk arrihet të kryhet asnjë sekuestrim tjetër pasurie, përveç atij të pagës, atëherë për këto raste qëndron me vend dhe do të duhet të aplikohet një masë sekuestrimi sa *30% e saj (pagës)* për nevoja të ekzekutimit.

Nisur nga këto raste përjashtimore evidentohen të metat e kësaj vakance ligjore të rregulluar disi vetëm më këtë direktivë dhe ekskluzivisht për trupën e përmbartuesve gjyqësorë dhe se si ky “minimum jetik” gjithashtu çënohet në rastet kur ka një vendim gjykate për detyrimin ushqimor apo kur subjektit debitor nuk i sekuestrohet asnjë pasuri tjetër.

Siç u shpjegua dhe më sipër, termi “minimum jetik” duhet parë si një limit i pa cenueshëm dhe i paprekshëm për të përballuar nevojat bazë të jetesës si qenie njerëzore dhe prekja e saj do sillte cënimin e këtij parimi. Ndaj, sanksionimi i tij me këtë direktivë ngelet i pamjaftueshëm dhe i vesuar edhe pse i limituar vetëm në një zhanër specifik, edhe aty ai nuk përmbush plotësisht kriteret e pranuar globalisht për këtë koncept. Ndërhyrja me mjete të reja ligjore për përcaktimin dhe garantimin e këtij parimi është e domosdoshme.

Përcaktimi i treguesit zyrtar të minimumit jetik është bërë domosdoshmëri gjithashtu për zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare, si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), (ILO është e përkushtuar të promovojë politika mbi pagat dhe të ardhurat që sigurojnë një minimum jetik për të gjithë të punësuarit që kanë nevojë për një mbrojtje të tillë), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore.¹⁸

18 Rekomandime të referuara si porosi e organizatave në fjalë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 119, datë 08.03.2001 “Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin “Minimumi Jetik, Zyrtar””.

Me vlerë është të referohet edhe raporti i vitit 2016 i bërë nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me ACER (Albanian Centre for Economic Research),¹⁹ i cili ka vlerësuar se përlllogaritja e këtij minimumi, përcaktohet në shumën 16,000 lekë dhe nëpërmjet një analize të thjeshtë krahasimore vlerësohet se standardi i pagës minimale, pensionit minimal, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë në vend është më i ulët se niveli i llogaritur i minimumit jetik prej 16,000 lekë në muaj për frymë.

Ndonëse ky raport nuk ka vlerën detyruese apo juridike të trajtohet si detyrim ligjor, një nga konkluzionet e tij është pikërisht nevoja e përcaktimit me ligj të detyrimit për llogaritjen e minimumit jetik dhe institucionit përgjegjës të ngarkuar me këtë detyrë, dhe reflektimi në legjislacionin i nevojës për indeksimin e këtij treguesi çdo vit. Ky ka qënë një nga rekomandimet e raportit të mëparshëm, por duket se ende pas 5 viteve ky rekomandim do të mbetet edhe në këtë raport.

Shqetësimi për këtë çështje është ngritur në nivel debati publik dhe nga një tjetër institucion publik, më konkretisht *Kontrolli i Lartë i Shtetit*, i cili në vitin 2018 ka reaguar me akte dhe komunikime shkresore kundrejt institucioneve të tjera, ku thekson se mungesa përcaktimit të termit *minimum jetik* në legjislacion, ka prekur thellësisht nivelin e jetesës së familjeve me ndihmë ekonomike. Mbi këtë bazë, KLSH-ja ka kërkuar që institucionet të angazhohen për nisjen e një studimi, që do të nxjerrë minimumin jetik zyrtar (teksa thekson se vetëm nisma e institucionit tonë (sipas studimit të ACER referuar më sipër dhe e ngelur e pa kuadruar në ligj, ka tentuar këtë rregullim), por duket se nuk ka gjetur gatishmërinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të cilat kanë refuzuar duke thënë, se përgjegjësia për këtë studim shkon përtej këtyre institucioneve.

Në vazhdimësi, institucioni ynë ka luajtur një rol aktiv në drejtim të nxitjes së institucioneve përgjegjëse për miratimin e bazës së nevojshme normative që do të shërbente për llogaritjen e minimumit jetik në Shqipëri. Avokati i Popullit i ka propozuar Kryeministrit të Shqipërisë ngritjen e një grupi pune për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri, dhe në përgjigje të këtij Rekomandimi, janë bërë disa përpjekje nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për organizimin e punës për dhënien e rekomandimeve për mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen për të përcaktuar nivelin minimal të standardit të jetesës në Shqipëri.

Në vijim të interesimit pranë kësaj Ministrie, me shkresën Nr. 474/2, datë 09.03.2015, institucioni i Avokatit të Popullit u informua se kjo Ministri ishte e gatshme për fillimin e procesit të studimit dhe shpalljes së nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Pasi Avokati i Popullit organizoi më 25.10.2016 një Seminar për prezantimin e Studimit "*Llogaritja e Minimumit Jetik (Nga minimumi jetik si mbijetesë drejt një standardi jetese të arsyeshme)*", institucioni i Avokatit të Popullit vijoi sërish përpjekjet për të nxitur institucionet përgjegjëse për institucionalizimin e procesit të miratimit të minimumit jetik. Konkretisht, me shkresën Nr. 366, datë 21.12.2016, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë marrjen e masave të menjëhershme për përcaktimin e minimumit jetik dhe kryerjen e ndryshimeve ligjore në funksion të objektivave sociale. Me shkresën Nr. 2560/2, datë 22.05.2017 institucioni ynë u informua për disa tregues të përdorur ndër vite në funksion të përcaktimit të niveleve minimale të pagave dhe pensioneve. Gjithësesi, nga një vlerësim i këtyre treguesve, *mungonte një metodologji e unifikuar për llogaritjen e minimumit jetik mbi baza shkencore, dhe mbi të gjitha, rezultoi se këto tregues nuk ishin akomoduar në akte normative apo publikuar në mënyrë transparente për publikun e gjerë.*

19 "*Llogaritja e minimumit jetik në Shqipëri*" – Studim i Albanian Centre for Economic Research <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/LLOGARITJA%20E%20MINIMUMIT%20JETIK%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf>

Më tej, me shkresën Nr. 366, datë 21.12.2016 institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Ministrin të Shëndetësisë rishikimin e Ligjit Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, i ndryshuar, me qëllim mundësimin e zhvillimit të një baze të dhënash për zbatimin e metodologjisë së llogaritjes së minimumit jetik mbështetur në nevojat energjetike për një individ mesatar në ditë, të dhëna që duhet të publikoheshin periodikisht nga Instituti i Shëndetit Publik. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministri i Shëndetësisë, me shkresën Nr. 2242/1, datë 17.07.2017, ka informuar se publikimet e Institutit të Shëndetit Publik në lidhje me nevojat energjetike, pavarësisht se mbështeteshin në burime të organizatave ndërkombëtare, kishin *karakter informativ dhe jo normativ*.

Duke marrë në konsideratë angazhimet e vazhdueshme institucionale ndër vite për miratimin e minimumit jetik, Avokati i Popullit i ka kërkuar sërish Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informacion mbi ecurinë e procesit të shpalljes së minimumit jetik. Në përgjigje të shkresës tonë Nr. K1/I105-9 Prot., datë 19.02.2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgjigjet me shkresën e saj Nr. 1506/1, datë 13.03.2018 se këtij institucioni i nevojitej ekspertizë, burime njerëzore për kryerjen e anketimeve, bashkëpunim me partnerët socialë dhe universitetet, si dhe buxhet shtesë për kryerjen e këtij procesi. Pas përpjekjeve të vazhdueshme, në përgjigje të shkresës tonë Nr. K1/I105-11 Prot., datë 12.11.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka informuar Avokatin e Popullit me shkresën e saj Nr. 5413/1, datë 13.12.2019 se, në mungesë të burimeve të nevojshme, ajo i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe INSTAT duke i shprehur gatishmërinë për të qenë pjesë e grupeve të punës që mund të ngrihen nga këto institucione për të përcaktuar minimumin jetik.

Në konkluzion të këtyre përpjekjeve institucionale, institucioni ynë konstaton se megjithëse janë marrë disa hapa ndër vite, nuk është konkluduar në ndonjë raport apo kornizë normative për përcaktimin e minimumit jetik apo metodologjive të llogaritjes së tij.

2.3 Roli i institucioneve publike në kuadër të përcaktimit të minimumit jetik dhe obligimet e tyre në këtë drejtim

Institucionet qendrore qeveritare të përfshira në mënyrë direkte në çështje të minimumit jetik për shkak të fushës së tyre të veprimit janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMC) në misionin e vet përfshin garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, etj. Në strukturën e kësaj Ministrie, këto çështje janë në vëmendjen e një Zv.Ministri të posaçëm. Detyrat kryesore të MSHMC janë:

- hartimi i politikave, të programeve dhe legjislacionit për programet e asistencës sociale si dhe kontrolli i zbatimit të tyre;
- programimi i fondeve për programet e asistencës sociale;
- grumbullimi i të dhëna statistikore, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të asistencës sociale;

- hartimi dhe paraqitja enevojave për fonde për programet e asistencës sociale pranë Ministrisë përgjegjëse për Financat;
- administrimi i buxhetit të shtetit dhe menaxhimi financiar në kuadër të zbatimit të politikave sociale.

Shërbimi Social Shtetëror ka për mision, ndër të tjera, zbatimin e politikave dhe legjislacionin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Në përputhje me ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” këtë mision e realizon nëpërmjet:

- Administrimit të Shërbimeve Shoqërore për individët në nivel kombëtar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- Programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- Kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike;
- Monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar.

Ndërsa, Instituti Statistikave (INSTAT) ka rol ndihmues në këtë proces duke mbledhur të dhëna, përmes Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës etj., për gjetjen e mënyrave të reja të grumbullimit të informacionit, për përlogaritjet e indikatorëve socialë në vend, për publikimin dhe ofrimin e informacioneve për institucionet qeveritare.

INSTAT herë pas here ka publikuar statistika të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo bëjnë referime në minimumin jetik dhe lidhen me nivelin e konsumit sipas anëtarëve të familjes në çdo Bashki. Në analogji vlerësimi mbi rolin që INSTAT mbart në këto referime, lidhur me nivelin e konsumit të detajuar sipas madhësisë së familjes në çdo Bashki, rezultojnë se ky konsum është i ndryshueshëm në qarqe të ndryshme dhe përmbledh në fund të tabelës mesataren e konsumit në nivel kombëtar. Pra INSTAT, duke mbledhur e përpunuar të dhënat në nivel kombëtar e lokal, luan një rol thelbësor në politikën qeveritare si një faktor referues dhe me rëndësi në vlerësimet e mëtejshme në nismat ligjore. Të dhënat e tij janë bazë për përmirësimin e politikave përkatëse shtetërore.

Nga sa më sipër, vlerësojmë se nga një qark në tjetrin diferencat dhe perceptimi i shpenzimeve është i ndryshueshëm dhe si rrjedhojë, i tillë mund të konsiderohet dhe përlogaritja e një minimumi jetik në qarqe të ndryshme sipas kostove të jetesës dhe ndryshimit të saj. Një qytetar i rrethit Tiranë për shembull, ka nevojë për kushte jetesa më të larta në vlerë (të cilat lidhen me shërbimet, transportin, qiranë), se sa mund të ketë një qytetar i rretheve të tjera më të vogla. Madje, edhe brenda të njëjtit qark ka ndryshime të këtyre nevojave.

Në një gjykim të kujdesshëm i cili lidhet me rolin e institucioneve publike në qasjen kundrejt këtij minimumi, duke pasur parasysh hierarkinë ligjore dhe detajimin e përshkallëzuar të elementeve ligjore në kurbë zbritëse (nga Kushtetuta në akte nënligjore), duke paramenduar se fryma e Kushtetutës përfshin një jetesë me dinjitet për këdo, Kuvendi me ligj, duhet të sanksionojë qartë konceptin e minimumit jetik. Po kështu, duhet të sanksionohet fakti se paprekshmëria e këtij minimumi jetik është parakusht dhe nëse ka raste përjashtimore kur për rrethana specifike ky minimum preket, çfarë masash duhet të merren për të rregulluar pasojat që burojnë nga ajo. Ligji duhet të sanksionojë dhe format se si do të arrihet përmbushja e kësaj norme kushtetuese, në çdo individ dhe familje.

Por edhe pse ky parim nuk sanksionohet në Kushtetutë si terminologji konkrete, pasi nuk hyn as në praktikën e kushtetutave evropiane, nevoja e sanksionimit me ligj, ngelet fillesa e domosdoshme, duke vlerësuar se ekziston çdo parakusht kushtetues për ta rregulluar me akt ligjor këtë element.

Për sa i përket detajimit në vlerë të saktë me shifra të këtij minimumi, për shkak të dinamikës së ndryshimit të tij, i cili lidhet me ndryshimin e çmimeve, kostove të jetesës, dhe shumë elementëve të konsumit të përditshëm, sanksionimi i kësaj vlere, me ligj, do të ishte i pa volitshëm. Ministria e linjës duhet të jetë në këtë rast organi i cili mund të aplikojë me vendim ndryshueshmërinë e herë pas herë të kësaj vlere duke ju referuar vlerësimeve të marra nga INSTAT, apo organizma të tjera dhe duke i kaluar në ekspertizë të detajuar vlerat e sugjeruara. Kjo, ndoshta duke përcaktuar limite ligjore për të ndaluar një ulje hipotetike të këtij standardi, pasi është vendosur një rritje e mëparshme, apo për të siguruar disa garanci ekonomike dhe politike. Kjo vlerë do të ishte e rëndësishme të përcaktohet për individë dhe për familje, si vlera të ndryshme sasiore mbështetur në formula matematikore të vlerësuara nga ekspertë.

Nëse vlerësojmë shembuj të vendeve të tjera, ku në shumë raste ky nivel përcaktohet në rang kombëtar dhe është i njëtrajtshëm, për t'u pasur në konsideratë do të ishte dhe një përcaktim i këtij minimumi në nivel qarku duke u nisur nga ndryshueshmëria në nivelin e jetesës nga një qark në tjetrin. Në këtë rast një sanksionim me ligj në nivele referuese minimum – maksimum, dhe i detajuar nga organet vendore (Bashkia, Prefektura, Këshilli Qarkut) në raste konkrete mund të ishte një model atipik, por më i drejtë dhe më në përputhje me parimin e decentralizimit të ushtrimit të pushtetit. Megjithatë, një opsion i zbatueshëm dhe i balancuar mbetet edhe paracaktimi i minimumit jetik nga pushteti qendror për secilin qark në mënyrë të diferencuar, ose për Tiranën dhe pjesën tjetër të vendit.

Nuk duhet harruar fakti se sanksionimi i një minimumi jetik sipas rrugëve së propozuara më sipër, dhe lindja e detyrimit së pari nga institucionet shtetërore për të siguruar atë minimum, do të duhej të sillte për rrjedhojë dhe ndryshime rrënjësore në shumë akte ligjore ekzistues, kryesisht legjislacionin social, më konkretisht; ligjin Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit", ligjin Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet ligjore në zbatim të tyre. Kjo lidhet dhe me aftësinë paguese të shtetit kundrejt këtyre kategorive vulnerabël dhe natyrisht që aplikimi i saj has vështirësi konkrete dhe përbën sfida të reja për ligjvënësin.

Më tej duhet vlerësuar edhe raporti i një individi i cili është i aftë për punë, dhe refuzon mekanizmat ligjorë të punësimit ndërmjet ndërmjetësimit të organeve shtetërore (zyra e punës), kundrejt detyrimit të shtetit për t'i siguruar një pagesë minimale jetese. Ky është një debat i ngritur edhe në vende të zhvilluara evropiane dhe kujdesi ndaj këtij vlerësimi duhet të jetë i atillë, për të mos krijuar paradokse, dhe të jetë në të njëjtën kohë në shërbim të atyre që kanë më së shumti nevojë.

2.4 Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Çështjet e lidhura me minimumin jetik nuk janë një fushë e panjohur për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Praktika gjyqësore e saj mbi këtë temë ka marrë hov, veçanërisht gjatë njëzet viteve të fundit. Ndonëse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk ka një referim specifik konkret të lidhur me minimumin jetik, ankesat e kësaj natyre zakonisht rishikohen në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo dispozitë garanton të drejtën për mbrojtjen e pronës. Një nga çështjet e ndjekura nga GJEDNJ që lidhet me zhvillimet e jurisprudencës së GJEDNJ sa i takon minimumit jetik është çështja *Baczúr kundër Hungarisë*. Në këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se, për përcaktimin nëse një ndërhyrje shtetërore në një përfitim social është proporcionale apo jo, duhet marrë në konsideratë, nëse individi ende përfiton një minimum jetik dhe pas ndërhyrjes shtetërore.

- Çështja *Baczúr kundër Hungarisë*

Në këtë çështje, Z. Baczúr pretendoi se, duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore, ai ligjërisht priste përfitime më të përshtatshme nga shteti. Për shkak se shteti hungarez kishte ndryshuar sistemin e përfitimeve sociale duke ulur ndjeshëm përfitimet e pensionit për shkaqe shëndetësore, ankuesi pretendonte se kishte pësuar një barrë joproporcionale ndërsa humbi për një vit e gjysmë më shumë se dy të tretat e përfitimit që ai pretendonte.

Në vlerësimin e saj, Gjykata theksoi se, në lidhje me përfitimet sociale, për njohjen e një pretendimi që konsiston në një pritshmëri legjitime, ankuesi duhet të ketë një të drejtë të njohur nga ligji kombëtar. Gjykata vlerësoi se që nga viti 1996 Z. Baczúr kishte vazhdimisht të drejtë, megjithëse nën regjime të ndryshme ligjore, për një përfitim social për shkak të aftësisë së kufizuar. Ajo arriti në përfundimin në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 1 Protokollit 1 i Konventës, se pretendimi i tij për një përfitim gjatë periudhës në fjalë përbente një interes parësor të njohur sipas ligjit kombëtar.

GJEDNJ vuri në dukje se ndërhyrja padiskutim kishte një bazë në ligjin kombëtar dhe theksoi që, nëse një person fillon të përfitojë nga një sistem shtetëror të sigurimeve shoqërore, kjo nuk do të thotë që sistemi nuk mund të ndryshohet në lidhje me masën e përfitimit. GJEDNJ pranoi mundësinë e ndryshimeve në legjislacionin e sigurimeve shoqërore të cilat mund të miratohen në përgjigje të ndryshimeve shoqërore dhe pikëpamjeve evolucionare mbi kategoritë e personave që kanë nevojë për ndihmë sociale. Megjithatë, marzhi i vlerësimit nga shtetet nuk përjashton një test proporcionaliteti. Ky test shqyrton nëse ndërhyrja i ka vënë një barrë të tepruar individuale Z. Baczúr, në dritën e kontekstit specifik të një skeme të sigurimeve shoqërore. E rëndësishme në këtë drejtim është nëse e drejta e tij për të marrë përfitime nga skema në fjalë ka dëmtuar thelbin e të drejtës të tij të pensionit.

Sipas Gjykatës, një ulje e dy të tretave, si në rastin në fjalë, padyshim hyn në këtë kategori. Gjykata gjeti si problematik faktin që përfitimi i marrë ishte sa 60 % e nivelit minimal të jetesës në atë kohë. Kjo ishte veçanërisht shqetësuese pasi Z. Baczúr nuk dukej se kishte të ardhura të tjera të konsiderueshme dhe i përkiste një grupi vulnerabël, përkatësisht personave me aftësi

të kufizuara. Prandaj, ndërhyrja shtetërore nuk kishte arritur një ekuilibër të drejtë. Pavarësisht nga marzhi i gjerë i dhënë shtetit në këtë fushë, ankuesi u ballafaqua, në periudhën përkatëse, me një barrë të tepruar individuale dhe kështu neni 1 i Protokollit 1 të Konventës është shkelur.

Ky rast i referuar më sipër tregon se si Gjykata Ndërkombëtare lexon aplikimin e nenit 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së (të ratifikuar edhe nga Shqipëria) kundrejt ndryshimeve ligjore në një shtet të caktuar dhe mbrojtjen e individit kundrejt veprimeve shtetërore. Përmbledhtazi, thelbi i këtij vendimi mbron interesin individual të një shtetasi kundrejt veprimeve shtetërore të cilat prekin të ardhurat bazike të tyre në vlerë të konsiderueshme dhe domethënëse.

2.5 Praktika nga vende të tjera dhe qasjet e tyre ndaj konceptit të minimumit jetik

Në vendet e tjera aplikohen politika të ndryshme të konceptit të minimumit jetik të cilat lidhen me faktorë historik, tradicionalë, ekonomik, politikë dhe socialë. Natyrisht që aplikimi kundrejt këtij koncepti pasqyrohet dhe në rolin që kanë politikatat sociale në secilin shtet.

Le të konsiderojmë qasjet e disa vendeve lidhur me trajtimin që i bëjnë konceptit të minimumit jetik. Në Prill 2016 qeveria britanike prezantoi dhe miratoi një normë më të lartë të pagesës që lidhej direkt me minimumin jetik për të gjithë punonjësit mbi 25 vjeç. Minimumi Jetik Kombëtar u zbatua përmes një ndryshimi në Ligjin Kombëtar të Pagave Minimale, të vitit 1998. Kjo normë hyri në fuqi më 1 Prill 2016.²⁰Sipas saj pagesa në orë e pagës minimale kombëtare për qëllimet e nenit 1 të Aktit të amenduar, është 7.20 £ për moshat mbi 25 vjeç. Tek ky amendim, për moshat nën 25 vjeç, nivelet e pagës minimale kishin parasysh gjithashtu dhe përbalueshmërinë e punëdhënësve për të mbuluar ato paga.

Për ta detajuar më tepër, praktika angleze vlerëson dy standarde, minimumi jetik për Londrën dhe ai në nivel kombëtar, teksa i pari reflekton vlera më të larta se sa i dyti.²¹ Në Angli ekziston i sanksionuar minimumi jetik kombëtar, siç kemi përmendur më sipër, i cili është vendosur nga shteti dhe minimumi jetik vullnetar, i rekomanduar nga Fondacioni i Minimumit Jetik, e cila është natyrisht vlerë më e lartë por nuk ka fuqi ligjore por vetëm rekomanduese. Këto referime vlerësohen në kuadër të të punësuarve dhe nuk specifikohen apo gjenden referenca në raport me personat e papunë apo pjesë e programeve sociale.

Një tjetër shembull vjen nga Italia. Llogaritjet e minimumit jetik në Itali bazohen në koston e jetesës për një shportë ushqimore që llogaritet nga baza e të dhënave e FAO, duke dalluar 50 grupe ushqimore të konsumit të ushqimit në njësi / për frymë, shpenzimet për strehim dhe për transport, me një diferencë për shpenzimet e papritura. Të dhënat për çmimet e këtyre artikujve

20 "The National Minimum Wage (Amendment) Regulations 2016" <https://www.legislation.gov.uk/uksi/2016/68/contents/made>

21 LondonLivingWage <https://www.london.gov.uk/what-we-do/business-and-economy/london-living-wage#:~:text=The%20London%20Living%20Wage%20is,the%20essentials%20and%20to%20save.>

mblidhen përmes një sondazhi online. Minimumi jetik në Itali u ul në 935 euro / muaj në 2018, nga 950 euro / muaj në 2017.²²

Për të subvencionuar shtresat në nevojë, në vitin 2018 sinteza e programit të qeverisjes së re ishin taksa të ulëta dhe minimum jetik, ose ajo që “Lëvizja Pesë Yje” e quante të ardhurat e qytetarisë, që në programin e tyre ishte 800 euro / muaj për ata që janë të papunë. Kjo shikohej si mjet për të përmbushur minimumin jetik. Për këtë program, qeveria e re madje u paralajmërua nga Presidenti dhe Bashkimi Evropian për të mbajtur në rregull parametrat makroekonomikë. Italia ishte një vend me borxh të lartë publik dhe nisma të tilla do të ishin fatalë për ekonominë e saj. Në këtë kuptim, ulja e taksave dhe garantimi i një minimumi jetik, jo pak të vogël për hir të vërtetës, komentohej nga zëra të rëndësishëm të ekonomisë italiane si e pamundur. Mirëpo, politika funksionon dhe me një logjikë tjetër, me marrëdhënien emotive midis politikës dhe qytetarëve. Kjo, tregon dhe faktin se një minimum jetik ka një përlllogaritje nevojash, por lidhet ngushte dhe me mundësitë e një vendi dhe një qeverie nën një kontekst të caktuar historik, ekonomik dhe politik. Ndaj kujdesi për përcaktimin e saj dhe ruajtjen e balancave të përmendura është determinante.

Minimumi jetik në Spanjë u rrit në 855 euro / muaj në 2018, nga 820 euro / muaj që ishte në vitin 2017. Llogaritja e minimumit jetik atje bazohet në të njëjtat kritere si në Itali.²³(nga baza e të dhënave e FAO, duke dalluar 50 grupe ushqimore të konsumit të ushqimit në njësi / për frymë, shpenzimet për strehim dhe për transport, me një diferencë për shpenzimet e papritura). Në prill të 2020, qeveria e Spanjës sanksionoi se do të paguajë mijëra familje me të ardhura të ulëta, me një “pagë minimale jetese” duke filluar nga Maji, një premtim i fushatës që është përshpejtuar për shkak të humbjeve masive të punës të shkaktuara nga bllokimet e pandemisë COVID 19. Qeveria Socialiste e vendit vlerësoi se subvencioni do t’i paguhej të paktën një milion familjeve mbi një bazë të përhershme duke filluar nga maji. Edhe pse nuk vendosën një shifër konkrete mbi nismën e tyre të quajtur “paga minimale e jetesës”, por la hapësirë subjektive.

Shembujt e mësipërm ilustronë rastet kur me veprime direkte qeveritë ndërmarrin veprime për të mundësuar arritjen e minimumit jetik (tashmë të sanksionuar me vlera më parë) tek secili qytetar, ose të paktën tek sa më shumë qytetarë që të jetë e mundur.

Në Shtetet e Bashkuara, pragu i varfërisë azhurnohet çdo vit nga Byroja e Regjistrimit. Në vitin 2020, në Shtetet e Bashkuara, pragu i varfërisë ose minimumi jetik llogaritet i diferencuar për një person apo për një familje me disa anëtarë; Një analizë e minimumit jetik, duke përpiluar të dhëna specifike gjeografike të shpenzimeve për ushqimin, kujdesin për fëmijët, kujdesin shëndetësor, strehimin, transportin dhe nevojat e tjera themelore, zbulon se ky minimum përlllogaritet në 16.54 dollarë në orë, ose 68.808 dollarë në vit, në 2019, përpara se këto të ardhura të taksohen, për një familje me katër (dy të rritur që punojnë dhe dy fëmijë), krahasuar me 16.14 dollarë në orë në vitin 2018.²⁴

22 “Italy Living Wage Individual” <https://tradingeconomics.com/italy/living-wage-individual#:~:text=Living%20Wage%20Individual%20in%20Italy%20averaged%20893.75%20EUR%2FMonth%20from,825%20EUR%2FMonth%20in%202015.>

23 “Spain Living Wage Individual” <https://tradingeconomics.com/spain/living-wage-individual#:~:text=Living%20Wage%20Individual%20in%20Spain%20is%20expected%20to%20reach%20841.32,macro%20models%20and%20analysts%20expectations.>

24 New Living Wage Data for Now Available on the Tool <https://livingwage.mit.edu/articles/61-new-living-wage-data-for-now-available-on-the-tool#:~:text=The%20living%20wage%20in%20the,wage%20for%20most%20American%20families.>

Në Gjermani, qeveria e klasifikon një individ si në rrezik për të rënë në varfëri nëse të ardhurat e tij janë më pak se 60% të mesatares së të ardhurave në nivel kombëtar. Në 2019, kjo vlerë ishte llogaritur si më pak se 1,074 euro çdo muaj. Për të ilustruar një shembull konkret, një shtetas gjerman filloi të punojë pas shkollës së mesme, së pari në një bankë, pastaj si shofer taksie dhe pastaj si kujdestar. Por kur doli në pension në të gjashtëdhjetat e tij, gjithçka që ai mund të përfitonte ishte një pension mujor prej 335 euro, që arrin në gati një të tretën e pragut gjerman të varfërisë (minimumit jetik). Ai menjëherë kërkoi ndihmë nga qeveria për të përmbushur nevojat e tij themelore. Shteti tani i paguan atij afërsisht 300 € shtesë dhe i mbulon gjysmën e qirasë. Ky shembull tregon angazhimin dhe përgjegjësinë e shtetit gjerman në garantimin e përmbushjes së këtij minimumi si një detyrim ligjor, pa një përcaktim të një pragu minimumi jetik, shteti gjerman nuk do të siguronte dot mekanizma për të vepruar në plotësimin e nevojave bazike të këtij individi.

Koncepti i minimumit jetik është analizuar edhe në Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë jo vetëm në raste individuale, por edhe në rastin e ligjeve federale. Me interes në këtë drejtim është Vendimi 1/09, datë 09.02.2010 i kësaj Gjykate, në të cilin është marrë në shqyrtim Ligji i Katërt për Shërbimet Bashëkohore në Tregun e Punës i datës 24.12.2003, me efekt nga 01.01.2005. Ky ligj integroi asistencën e papunësisë me përfitimet e tjera sociale duke krijuar një mbështetje uniforme për personat e aftë për punë dhe anëtarët e familjeve të tyre sipas një standardi të mjeteve të nevojshme për jetesë. Gjykata Kushtetuese ka evidentuar disa parime thelbësore kushtetuese me rëndësi në gjykimin e çështjeve të shtruara për interpretim. Kështu, e drejta themelore për garantimin e një minimumi jetik, e cila është në të njëjtën linjë me dinjitetin njerëzor, i cili buron nga neni 1.1 i Ligjit Themeltar në lidhje me parimin e shtetit social të parashikuar në nenin 20.1 të Ligjit Themeltar, i siguron çdo personi në nevojë kushtet materiale të domosdoshme për ekzistencën fizike dhe pjesëmarrjen minimale të tij në jetën sociale, kulturore dhe politike.²⁵ Këto të drejta kushtetuese nuk janë në diskrecion të plotë të legjislatorit, dhe duhet të respektohen. Legjislatori duhet t'i orientojë politikën e veta në përputhje me nivelin e zhvillimit të vendit, dhe me kushtet aktuale të jetesës në vend. Është e evidente që llojet e mjeteve dhe nevojave që duhet të sigurohen nuk mund të shpëputen nga Ligji Themeltar, dhe këto i përcakton legjislatori. Megjithatë, legjislatori duhet të vlerësojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për ekzistencën e një personi sipas nevojave konkrete, pra në përputhje me realitetin, dhe duhet ta bëjë këtë nëpërmjet një procedure të qëndrueshme dhe transparente. Në mënyrë që Gjykata të vlerësojë drejt kushtetueshmërinë e ligjeve, ajo merr në shqyrtim katër kritere themelore, sikurse janë:

1. Nëse legjislatori ka marrë në konsideratë dhe nëse e ka vlerësuar drejt objektivin e sigurimit të ekzistencës së individit në përputhje me dinjitetin njerëzor të parashikuar në nenin 1.1 në lidhje me nenin 20.1 të Ligjit Themeltar;
2. Nëse legjislatori, brenda kufijve të diskrecionit të tij, ka zgjedhur një metodë llogaritjeje në thelb të përshtatshme për llogaritjen e minimumit jetik;
3. Nëse legjislatori në thelb i ka marrë në shqyrtim dhe i ka vlerësuar saktë të gjitha faktet themelore; si dhe

²⁵ Deklaratë për shtyp e Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane Nr. 5/2010 e datës 09.02.2010 mbi Vendimin 1 BvL 1/09 të datës 09.02.2010, <https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Pressemitteilungen/EN/2010/bvg10-005.html>

4. Nëse legjislatori i ka kryer llogaritjet e tij me shifra të duhura dhe brenda kufijve të justifikuar sipas metodës së llogaritjes dhe parimeve të saj strukturore.

Ky vlerësim është i mundur vetëm nëse legjislatori i bën transparente metodat dhe fazat e llogaritjeve në përputhje me nenin 1.1 në lidhje me nenin 20.1 të Ligjit Themeltar gjerman.

Në vende të ndryshme, sikurse rezulton nga një raport i Komisionit Evropian i vitit 2015 "Minimum income schemes in Europe" ku janë marrë në konsideratë shtete të ndryshme të cilat kanë skema të aplikimit të minimumit jetik ose lloje të skemave të ngjashme, këto skema shihen si mjete të fundit për të parandaluar skamjen dhe për të siguruar një minimum jetik. Sipas këtij raporti, Greqia dispononte vetëm një skemë pilot, në Itali skemat ishin të kufizuara në rajone të caktuara dhe Turqia nuk ka referenca për skema të tilla.

Karakteristikat e skemave ndryshojnë shumë dhe mund të identifikohen pesë lloje kryesore:

- a) *skema të thjeshta dhe gjithëpërfshirëse, të hapura për të gjithë qytetarët të cilët janë me mjete të pamjaftueshme për të mbështetur veten, këtu kategorizohen shumë vende të zhvilluara dhe disa rajone po me potencial ekonomik në Itali;*
- b) *skema të thjeshta dhe jo kategorike por me përshtatshmëri dhe mbulim të kufizuar;*
- c) *skemat e përgjithshme si mundësitë e fundit për përfitime shtesë, të cilat mbulojnë shumicën e njerëzve që kanë nevojë për mbështetje, si Finlanda apo disa rajone të Italisë jugore;*
- d) *lidhje komplekse të skemave të ndryshme, shpesh kategorike dhe nganjëherë të mbivendosura, të cilat mbulojnë shumicën e njerëzve në nevojë për mbështetje (Franca, Rumania, etj.); dhe*
- e) *skema shumë të kufizuara, të pjesshme të cilat kufizohen në kategori të caktuara njerëzish dhe nuk arrijnë të mbulojnë shumë prej atyre që kanë nevojë për mbështetje.²⁶*

Aplikimi i këtyre skemave shikohet si një nismë suplementare për të siguruar minimumin jetik për çdo qytetar të vendit të tyre dhe mënyrat që të çojnë në plotësimin e kësaj nevoje janë të shumta. Ajo që është kusht paraprak për të gjetur këto mënyra, është paracaktimi i një niveli minimal ligjor. Vetëm më pas mund të ri-vlerësohen politikat shtetërore që çojnë në plotësimin e kësaj nevoje.

Konkretisht në vendet kryesore të Bashkimit Evropian minimum zyrtar është mesatarisht 1 mijë euro për frymë në muaj. Minimumin jetik më i lartë referuar i vitit 2015 dhe shifrave të Eurostat të bëra prezentë në një studim, e kishte Danimarka me 1418 euro në muaj për frymë, e ndjekur nga Finlanda, Austria, Mbretëria e Bashkuar, Holanda që nuk zbresin nën kufirin 1 mijë euro.

Si konkluzion i këtij nënkapitulli, në legjisacionin e vendeve Evropiane shikojmë dy elementë paralel që kompletojnë njëra tjetrën. Së pari një nivel minimumi jetik i përcaktuar në shifra konkrete me ligj ose akt tjetër nënligjor i cili shikohet si garanci për qytetarët dhe si një kufi varfërie i paprekshëm dhe së dyti, me kusht që ky referim mos ngelet thjesht i sanksionuar në akt, por i pa aplikueshëm, një sërë mekanizmash ligjorë, të ndryshueshëm dhe të vazhdueshëm

se si orientohen shtetet që ky rregullim të prek direkt secilin qytetar të vendit respektiv, ndërmjet skemave të ndryshme që ata zgjedhin të aplikojnë, si asistencat, pensionet, ndihmat ekonomike, subvencionet shtetërore, programe sociale etj. Teksa ky parim implementohet fare thjesht tek personat e punësuar, tek të cilët dhe mund të mjaftohemi me referimin ligjor në pagën minimale, vështirësia e zbatimit të kësaj norme lind në momentin që si pasojë e një faktori tjetër, të jashtëm, kjo pagë detyrohet të preket dhe lind nevoja e një garancie të dytë ligjore. Gjithashtu vështirësitë kryesore dhe sfidat me të cilat përballet aplikimi i kësaj nevojë është në rastet e personave të cilët janë të papunë ose pjesë e skemave sociale që lidhen me paaftësinë e tyre për të punuar si dhe pensionistët. Për këto raste shtetet investohen me nisma ligjore të vazhdueshme që minimumin jetik të caktuar me vlerë, ta impelemtojnë në çdo individ që nuk e arrin atë me mjetet që ka në dispozicion.

2.6 Problematika të zbatueshmërisë

Si u nënvizua në çdo kapitull, si një problem global dhe lokal, sfidat me të cilat duhet të përballen shtetet lidhur me pragun e varfërisë nuk mjaftohen në përcaktimin e një niveli minimumi jetik. Ky nivel duhet të jetë arritshëm dhe i mundshëm për këdo. Pasi të sanksionohet me një normë ligjore niveli i minimumit jetik, një shtet ka detyrimin të prek dhe një sërë legjislacioneesh të tjera sociale dhe buxhetore, për të mundësuar zbatimin e plotë dhe efektiv të këtij standardi tek qytetarët dhe familjet.

Sot në Shqipëri, minimumi jetik edhe pse ekziston si terminologji në disa referime ligjore, më konkretisht në Kodin e Procedurës Civile apo akte të tjera nënligjore, ka paradoksin që të jetë i pa caktuar në vlerë numerike. Një caktim i këtij niveli, përveçse i domosdoshëm dhe me rëndësi jetike, duhet të shoqërohet menjëherë me ndryshime në legjislacionin vijues dhe kryesisht Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, apo gjithë kuadrin ekzistues ligjor që ka efekte subvencionimi financiar ndaj qytetarëve. Kjo është sfida e vërtetë e një legjislacioni për të mundësuar zbatimin e kësaj norme ligjore dhe plotësimin e nevojave minimale për një jetesë normale dhe me dinjitet.

Shembujt se si implementohet kjo nismë në vendet e tjera na bëjnë vigjilent që të kemi parasysh dhe efektet anësore në ekonomi dhe si do përballohen ato nga punëdhënësit ose buxhete shtetërore. Shembulli anglez i cili garanton tjetër nivel page minimale për punonjësit mbi dhe nën 25 vjeç sjell një ide të kujdesit që kanë këto vende për të ruajtur balancat e duhura në sistem. Gjithashtu parashikimi i ndryshimeve në nivele qarqesh ose rajonesh, ngelet sa i vështirë por edhe teknikisht i ndërlikuar në një përllogaritje sa më pranë realitetit.

Një strategji e mirëfillte është e nevojshme e cila sjell së pari parashikimin e këtij niveli të minimumit jetik si vlerë dhe pastaj një sërë mekanizmash të shtrirë në kohë, që e bëjnë atë të zbatueshme në çdo aspekt të jetës social-shoqërore, tek çdo marrëdhënie pune dhe pasqyrimin në të gjithë legjislacionin shqiptari cili preket direkt dhe indirekt nga kjo risi.

2.7 Përfundime dhe Rekomandime

- Përfundime

Nga analiza e legjislacionit shqiptar në tërësi rezulton se minimumi jetik është një normë ligjore që buron nga të drejtat kushtetuese të qytetarëve. Edhe pse koncepti i minimumit jetik është i parashikuar prej më tepër se 2 dekadash si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave, kryesisht të punëmarrësve, mungojnë aktet nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik dhe përshtatjen e kësaj mase në planin kohor. Është e vështirë të identifikosh shkaqet e një vakumi të tillë normativ.

Gjithësesi, është fakt se në praktikë, kjo mangësi shërben si një premisë për standarde të dyfishta në mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve në lidhje me garancitë që ofron legjislacioni përsa i përket minimumit jetik.

Fusha praktike ku haset më së shumti kjo mangësi është fusha e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve monetare mbi pagat e punëmarrësve me të ardhura të ulta. Proceset ekzekutive mund të shkaktojnë rënien e kategorive të tilla të punëmarrësve në varfëri të skajshme nëse paga e tyre nuk mbrohet nga një minimum i paprekshëm.

- Rekomandime

Në mënyrë që minimumi jetik të integrohet në sistemin ligjor në mënyrë konstruktive së bashku me komponentë të tjerë të mbrojtjes sociale, është e nevojshme që të merren në konsideratë qasje konstruktive që marrin në konsideratë kërkesat normative të natyrës kushtetuese-juridike, sociale dhe ekonomike. Për të implementuar këtë qasje, kërkohen procese legjislative të cilat respektojnë dhe integrojnë në produktet e tyre kornizën e parimeve normative ligjore dhe kushtetuese të cilat udhëheqin debatin mes argumenteve të lidhura me normën e minimumit jetik.

Është e rëndësishme që vakumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik duhet të përfundojë sa më parë në mënyrë që të vendoset një standard normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike, si dhe të sigurohen garancitë e qytetarëve në drejtim të sigurimit të mjeteve të tyre të jetesës. Minimumi jetik duhet të sigurojë jetesë dinjitoze me shërbimet bazike dhe duhet t'u mundësojë njerëzve që të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar. Minimumi jetik duhet të bëhet një pjesë kryesore e sistemit kombëtar të mbrojtjes shoqërore dhe shëndetësore.

Legjislacioni duhet të parashikojë format dhe mjetet se si duhet të aplikohet ky minimum deri sa të mundësojë që çdo qytetar të përfitojë lehtësisht një garanci të tillë dhe mos mjaftohet vetëm me përcaktimin e vlerës shifrore të këtij koncepti. Edhe procesi legjislativ është i një rëndësie kushtetuese. Nisur nga eksperiencia kushtetuese e vendeve të tjera si Gjermania, ku jurisprudenca kushtetuese ka një rol autoritar në formësimin e standardeve optimale të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, është e rëndësishme që proceset legjislative të gëzojnë maksimalisht një legjitimitet kushtetues. Si të tilla, është e domosdoshme që në formulimin e minimumit jetik të merret në konsideratë dhe të vlerësohet drejt objektivi i sigurimit të ekzistencës së individit

në përputhje me dinjitetin njerëzor të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, në mënyrë të tillë që individit, përpos një jete dinjitoze, t'i mundësohet akses minimal në jetën kulturore, sociale dhe politike.

Legjislatori, brenda kufijve të diskrecionit të tij, duhet të zgjedhë një metodë llogaritjeje në thelb të përshtatshme për llogaritjen e minimumit jetik, si dhe duhet të marrë në shqyrtim dhe vlerësojë saktë të gjitha faktet themelore që lidhen me parimin e mësipërm. Edhe llogaritjet duhet të kryhen me shifrat e duhura dhe brenda kufijve të justifikuar sipas metodës së llogaritjes dhe parimeve të saj strukturore. Vetëm në këtë mënyrë, rezultati plotëson kriterin e një norme legjitime për mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve, si bazë kushtetuese e vetë shtetit dhe shoqërisë shqiptare.

Në hartimin e këtyre politikave, shteti shqiptar duhet të ketë në vëmendje standardet e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale dhe të Kartës Sociale Evropiane dhe, gjithashtu, të vlerësojë qasjen me standardet e Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integritimit.

3. Minimumi jetik, mbrojtja sociale dhe varfëria në Shqipëri

3.1 Politikat sociale ekzistuese për mbrojtjen sociale dhe minimumi jetik

Politikat për mbrojtjen sociale në Shqipëri mbështeten në objektivat sociale²⁷ që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka njohur si detyra të shtetit për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike apo fetare, jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore sa i përket sigurimit të ushqimit të nevojshëm, strehimit, shëndetit dhe arsimit.

Një nga dokumentat kryesore që qeveria shqiptare ka mbështetur ndërhyrjet e saj për zbatimin e varfërisë është Axhenda 2030 e Kombeve të Bashkuara dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm²⁸, ku një prej elementëve më të rëndësishëm të Qëllimit 1 për Zhvillimin e Qëndrueshëm është arritja e mbrojtjes sociale të qëndrueshme për këdo, me fokus të varfërit dhe grupet e cënueshme.

3.1.1 Politikat sociale për mbrojtjen sociale

Politikat kryesore për mbrojtjen sociale janë: a) ndihma ekonomike; b) pagesa për Aftësinë e Kufizuar dhe c) shërbimet e përkujdesit shoqëror. Strategjitet për mbrojtjen sociale përfshijnë kombinimin e politikave të mbrojtjes sociale me ato të përfshirjes sociale dhe të politikave aktive të punësimit. Gjithashtu, politikat e mbrojtjes sociale ndikojnë dhe ndikohen nga politikat e punësimit dhe sigurimeve shoqërore. Për qëllim të këtij raporti, kjo pjesë e tij do të fokusohet vetëm në politikën e ndihmës ekonomike si masa e drejtpërdrejtë që adreson varfërinë dhe zbatimin e saj.

Me Vendimin nr. 866, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave është miratuar Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023 si dhe Plani i Veprimit në zbatim të saj. Miratimi i kësaj strategjie ka shfuqizuar Strategjinë e mëparshme të miratuar me Vendim nr. 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave.

27 Kreu V, neni 59

28 <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>

Strategjia për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie janë dokumentat kryesorë politikë, që adresojnë varfërinë në mënyrë të integruar. Në këtë kuadër, strategjia përcakton si qëllimin e parë strategjik zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë²⁹ duke pasur si qëllim zbutjen e varfërisë nëpërmjet përmbushjes së objektivave: i) rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndhmës Ekonomike; ii) konsolidimi i skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të miradministrimit të regjistrimit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit; iii) rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike; iv) transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.

Në Planin e Veprimit për SMS 2015-2020, një nga objektivat e rëndësishëm të tij, në kuadër të qëllimit për zbutjen e varfërisë dhe reformimit të NE-së ishte rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor. Ky proces përfundoi me sukses nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pas një periudhe konsultimesh, me miratimin e ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i ligjit është: a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore; b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura; ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Miratimi i këtij ligji sollti një mekanizëm të ri që përcaktoi familjet dhe individët që mund të marrin NE, formulën e përlllogaritjes, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe mënyrën e veprimit të institucioneve shtetërore për administrimin e skemës.

Por, ligji ruan gjendjen e mëparshme në lidhje me minimumin jetik, nuk e përkufizon dhe as nuk përcakton si përlllogaritjet dhe cila është përgjegjësia e qeverisë për nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore, që realizojnë të drejtën për të pasur jetë të shëndetshme dhe dinjitoze. Kështu, edhe legjislacioni i ri për asistencën sociale nuk njeh minimumin jetik si bazë për politikën e NE-së dhe të pagesave të tjera si pagesa për Aftësinë e Kufizuar, etj.

Gjithashtu, ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” përcakton në detaje kategoritë e subjekteve që përfitojnë NE, duke favorizuar kategori të veçanta, por në vlerësimin e ekspertëve të intervistuar për këtë studim, ky kategorizim kaq i detajuar mund të sjellë përjashtim të kategorive që nuk janë përmendur në ligj specifikisht.

29 Qëllimet strategjike në këtë dokument janë tre: a) zbutja dhe lehtësimi i varfërisë; b) përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara dhe c) zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social.

3.1.2 Situata aktuale e varfërisë në Shqipëri dhe efektiviteti i politikës së NE-së

Në Shqipëri, rreth 40% e popullatës jeton me 5.5 \$ në ditë dhe krahasuar me vendet e tjera në rajon si Serbia, Maqedonia, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, ky është niveli më i lartë i shtrirjes së varfërisë (World Development Indicators, 2018³⁰).

Grupet që janë më të disavantazuara dhe jetojnë në varfëri janë: i) të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, një pjesë e madhe e tyre janë të papërfshirë në arsim, punë apo kualifikim profesional (World Development Indicators, 2018³¹) dhe ii) fëmijët, sipas raportit të UNICEF për mirëqenien e fëmijëve, 19.2% e familjeve me fëmijë jetojnë në varfëri absolute (UNICEF, 2016).

Disa karakteristika të përbashkëta shoqërojnë familjet që jetojnë në varfëri, të tilla si: arsimimi i ulët i kryefamiljarit/es, papunësia e kryefamiljarit/es; numri i madh i anëtarëve të familjes (HBS, 2016). Familjet me fëmijë 0-5 vjeç dhe me fëmijë adoleshentë ndodhen në fashën më të ulët të varfërisë absolute, që do të thotë se këto grupe janë shumë të cënueshme nga varfëria.

Sipas studimit për Transfertat e Mbrojtjes Sociale drejt Familjeve të Varfëra (UNICEF, 2019³²), ku janë listuar kategoritë e shpenzimeve për familjet e varfëra, ushqimi zë pjesën më të madhe të shpenzimeve (rreth 96%) pa lënë asnjë hapësirë apo hapësirë të pakonsiderueshme për shpenzime për aktivitete të zhvillimit njerëzor si shëndeti apo edukimi si dhe aktivitete të tjera zhvilluese si psh transporti, komunikimi, rikrijimi dhe kultura.

Kjo do të thotë, që jo vetëm masa e NE është shumë e ulët, por edhe që ndihmon në krijimin e ciklit të mbyllur të varfërisë duke i mbajtur grupet e cënueshme në të njëjtat kushte, pa ju krijuar mundësi për t'u arsimuar apo zhvilluar që të mund të dalin nga ky cikël. Nuk ka të dhëna apo studime që vlerësojnë se në çfarë niveli kjo masë ndihmon për zbutjen e varfërisë në nivel kombëtar apo rajonal dhe sa familje kanë dalë nga skema e NE-së në nivel kombëtar apo rajonal si pasojë e NE dhe strategjive për daljen nga skema.

Fëmijët dhe familjet e mëdha janë më të varfërat dhe grupet më të rrezikuara për të rënë në varfëri. Kjo do të thotë që nëse masa e NE nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për ushqimin por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor për individët dhe familjet kur ata kanë nevojë, ata rrezikojnë të riciklohen në ciklin e mbyllur të varfërisë duke mbajtur karakteristika të tilla si edukimi i ulët, papunësia dhe probleme me shëndetin.

30 World Development Indicators, World Bank aksesuar online në <http://datatopics.worldbank.org/world-development-indicators/>

31 World Development Indicators, World Bank, accessed on December 2017

32 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

3.1.3 Arritje dhe sfida

Përpjekjet për rritjen e efektivitetit dhe modernizimin e skemës së NE në Shqipëri me asistencën e Bankës Botërore, projekt i cili u zbatua në nivel kombëtar në 2018 (Banka Botërore, 2018), pas pilotimit në mënyrë të pjesshme (Tiranë, Durrës, Elbasan), patën rezultate pozitive në shumë aspekte. Kjo skemë pati edhe disavantazhe, të cilat qeveria i adresoi nëpërmjet fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për NE për Pushtetin Vendor, por kjo ndërhyrje nuk garantoi mbulimin e të gjitha familjeve që jetonin në varfëri për të pasur mbështetje financiare. Më poshtë do të analizohen arritjet dhe dështimet e skemës aktuale për NE, bazuar në rezultatet e studimeve të deritanishme si dhe të dhënat statistikore dalë nga INSTAT.

Ka një dakordësi midis studiuesve (Avokati i Popullit - ACER 2016³³, UNICEF, 2019³⁴) që reforma për NE pati rezultate pozitive veçanërisht në shënjestrimin e familjeve më të varfëra për t'u përfshirë në skemë, përfshirë këtu familjet me shumë fëmijë. Por kjo reformë pati edhe sfida, sidomos sa i përket masës së ulët të NE-së, nxjerrjes nga skema të familjeve të cilat ishin në rrezik të varfërisë dhe mosmbulimit të të gjitha katëgorive të konsumit të nevojshëm veçanërisht të atyre të natyrës sociale.

Kombinimi i mostargetimit të të gjithë familjeve me nivelin shumë të ulët të masës së NE sjell që kjo politikë të mos ketë rezultatin e dëshiruar për uljen e varfërisë. Shqipëria, krahasuar me vendet e tjera në rajon, ka shënjestrimin dhe masën më të ulët të NE-së (UNICEF, 2019³⁵) dhe si pasojë kjo politikë do të ketë edhe ndikimin më të ulët në uljen e varfërisë. Në një vlerësim të Bankës Botërore³⁶ (2012) NE nxjerr vetëm 0.4% të të varfërve nga varfëria. Të dhëna më të fundit mungojnë për sa i përket efektivitetit të këtyre politikave në uljen apo zbutjen e varfërisë në vend.

Numri i përfituesve nga skema e NE-së ka rënë nga 2015 (UNICEF, 2019³⁷), gjë që nuk ka rezultuar në një rritje të vlerësueshme të masës së NE përgjatë këtyre viteve, pa llogaritur as inflacionin në vend.

33 ACER 2016, Llogaritja e Minumumit Jetik në Shqipëri aksesuar në <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/LLOGARITJA%20E%20MINIMUMIT%20JETIK%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf>

34 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

35 Po aty

36 Banka Botërore, Raporti për Kushtet e Jetesës, 2012

37 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

Arritjet³⁸ mund të përmbliidhen si më poshtë:

- i. Përpjekja për ta kthyer skemën e NE nga një skemë pasive në një skemë aktive duke e lidhur me skemat e punësimit për të luftuar qëndrimin afatgjatë të përfituesve në skemë dhe njëkohësisht synuar riintegrimin social.
- ii. Lidhja formale mes skemës së NE-së me shërbime si arsimit, kujdesi shëndetësor dhe strehimi, pavarësisht masës shumë të vogël të pagesës për fëmijët në shkollë apo efektivitetit të skemave të strehimit social në nivel pushteti vendor.
- iii. Shënjestrimi i familjeve më të varfëra është arritur nëpërmjet reformës, mbështetur nga të dhënat që flasin për karakteristikat e familjeve brenda skemës që janë me kryefamiljarë me arsim të ulët dhe shumë të ulët si dhe të papunë afatgjatë (UNICEF, 2019³⁹).
- iv. Shënjestrimi i familjeve me shumë fëmijë ka rezultuar i suksesshëm për vetë skemën e përdorur për të mbështetur familjet me shumë fëmijë, veçanërisht familjet me më shumë se 3 (tre) fëmijë.
- v. Lehtësimi i ngarkesës administrative për pushtetin vendor duke ulur nivelin e intervistave me aplikantët por edhe ulja e dokumentacionit të kërkuar nga aplikantët, pavarësisht sfidave për aplikantët për të aplikuar online.

Sfidat⁴⁰ mund të përmbliidhen si më poshtë:

- i. Fondi i përdorur për programet e mbrojtjes sociale rezulton pothuajse i pandryshuar në vlerë në raport me PPB në vitet 2010-2017, rreth 9% e PPB (UNICEF, 2019⁴¹). Pjesa më e madhe e këtij fondi shkon për pagesat për aftësinë e kufizuar dhe sigurimet sociale, më pak për NE.
- ii. Pavarësisht reformimit të skemës së NE, masa e pagesës nuk ka ndryshuar ose ka ndryshuar në vlerë shumë të vogël. Masa prej 3500 Lekë-8000 Lekë nuk mbulon konsumin familjar të nevojshëm për përmbushjen e nevojave. Nuk ka studime apo të dhëna që të tregojnë se në çfarë mase mbulohen nevojat për konsum të familjeve të varfëra nga NE, por në një përlllogaritje të bërë nga Zlatko Nikoloski (UNICEF, 2019⁴²) rezulton që kjo masë mbulon vetëm 25% të konsumit familjar. Ndërkohë, sipas statistikave të publikuara nga INSTAT⁴³, për periudhën nga fillimi i vitit 2018 deri në tremujorin e tretë të vitit 2020 mesatarja e ndihmës ekonomike mujore për një familje është 5,192 lek.

38 Arritjet dhe Sfidat e skemës së re të NE-së u identifikuan në intervistat e thelluara me studiues të fushës në periudhën Tetor-Nëntor 2020 .

39 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

40 Arritjet dhe Sfidat e skemës së re të NE-së u identifikuan në intervistat e thelluara me studiues të fushës në periudhën Tetor-Nëntor 2020 .

41 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

42 Po aty

43 <http://instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>

- iii. Përrjashtimi nga skema e familjeve që nuk plotësojnë kriteret dhe që formula nuk i lejon të përfitojnë, si dhe e familjeve nga Komuniteti Rom, të cilët kanë mungesë të dokumentave identifikues (ID), gjë që i përjashton automatikisht nga përfitimi.
- iv. Mospërdorimi në praktikë i dy metodave të vlerësimit të familjeve në varfëri, asaj kompjuterike dhe vlerësimit në terren nëpërmjet vizitave në familje nga administratorët shoqërorë. Skema e re e NE dhe formula e aplikuar është tërësisht kompjuterike, gjë që përmban disavantazhe në vetvete, sepse ndodh që familje të cilat përjashtohen nga skema, rezultojnë që jetojnë në varfëri dhe ky verifikim mund të bëhet vetëm nëpërmjet intervistave me aplikantët dhe vizitave në mjedisin e banimit. Moskombinimi i këtyre dy mënyrave të vlerësimit, sjell si rezultat përjashtimin nga përfitimi të familjeve të cilat duhet të përfitojnë nga skema, sepse pushteti vendor nuk mund tëmbulojëkëto familje me ndihmë ekonomike për shkak tëpamjaftueshmërisë tëfondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për NE. Sa më sipër vërehet edhe nga të dhënat e institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me numrin e ankesave që administrohen në vit për këto çështje.
- v. Përqëndrimi në aspekte të administrimit, monitorimit dhe kontrollit të skemës dhe jo në efektivitetin e skemës për zbutjen e varfërisë, që është synimi kryesor i përdormit të saj. Sistemi i ri i NE u përqëndrua shumë në administrimin e një sistemi online për NE dhe aplikimin e një formule për të ulur shpërdorimet me NE dhe numrin e përfituesve abusive nga skema, gjë që ishte një shqetësim i madh për qeverinë. Por, reforma nuk balanço ndërrhyrjen për të mirëadministruar sistemin me ndërhyrjen e nevojshme për të rritur në vlerë të konsiderueshme masën e NE me qëllim që të ndikonte realisht në zbutjen e varfërisë në vend.
- vi. Transparenca dhe mungesa e kapaciteteve për të sqaruar qytetarët rritën mosbesimin e tyre ndaj skemës së re të zbatuar, çka është një problem i vijueshëm.
- vii. 6% në bashkitë e vogla është jo efektive për të përballuar nevojat e popullatës në zonat rurale.

3.1.4 Minimumi jetik

Studime të mëparshme për minimumin jetik në Shqipëri (Avokati i Popullit - ACER, 2016⁴⁴) si dhe studime për vende të tjera në faza të ngjashme të zhvillimit me Shqipërinë i referohen përkufizimit të ILO-s (ILO, 2012⁴⁵) për minimumin jetik, sipas të cilit minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave, që garanton që konsumi të përmbushë kërkesat e minimumit të nevojave fizike dhe sociale të qenieve njerëzore.

44 ACER 2016, Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri aksesuar në <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/LLOGARITJA%20E%20MINIMUMIT%20JETIK%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf>

45 ILO, 2012. Social Protection (Eastern Europe and Central Asia) Social and Economic Policy Working Briefs aksesuar në <https://www.ilo.org/moscow/areas-of-work/social-security/lang-en/index.htm>

Sipas këtij përkufizimi, nevojat që konsumi duhet të përmbushë janë të natyrës fizike dhe të natyrës sociale. Të dhënat e deritanishme për konsumin dhe kategoritë e tij nga familjet shqiptare tregojnë se masa e NE shpenzohet në masë pothuajse absolute për ushqim dhe fare pak ose aspak për nevojat sociale të individëve dhe të familjes. Plotësimi i nevojave sociale të individit dhe familjes është drejtpërdrejt i lidhur me faktorët mbrojtës për të mos rënë në nivelin e varfërisë, si psh. arsimimi, punësimi, transporti, komunikimi, gjë që do të thotë se në kushtet kur familjet nuk kanë mundësi të mbulojnë këto shpenzime ato rrezikojnë të qëndrojnë në varfëri, të jenë përfitues afatgjatë të skemës së NE, si dhe të riciklohen ata dhe fëmijët e tyre në rrethin e mbyllur të varfërisë.

Prandaj, politikat sociale për mbrojtjen sociale (specifikisht NE) kanë në fokusin e tyre jo vetëm mbulimin e konsumit për ushqime, por veçanërisht mbulimin e konsumit për aktivitete të zhvillimit njerëzor, të cilat rezultojnë sipas studimeve, faktorët dominantë që ndihmojnë për daljen e familjeve nga varfëria.

Paradigma e investimit social nënvizon financimet në sektorin social si produktive për uljen e varfërisë dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Të tilla investime, me ndikim mbi uljen e varfërisë janë në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor, formimit profesional, kujdesit për fëmijët dhe programet aktive të punësimit⁴⁶ (Matkovic, G. 2017). Investimi në zhvillimin njerëzor, nxitjen e punësimit dhe politikat aktive dhe parandaluese duhet të bashkëshoqërojnë politikat për mbrojtjen sociale.

Mospërkufizimi ligjor i Minimumit Jetik dhe mungesa e një dispozite të veçantë për të në legjisllacionin shqiptar (Avokati i Popullit – ACER, 2016) nuk lehtëson qeverinë në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre dhe si rrjedhim edhe të objektivave dhe të treguesve të matshëm që synohet të arrihen në periudha të caktuara kohore.

3.2 Politika të suksesshme të mbrojtjes sociale të lidhura me minimumin jetik në Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur sfidat e tyre sa i përket mbulimit dhe fondeve të limituara për NE, por megjithatë këto vende kanë një sistem të ngritur dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale, veçanërisht ish-Republikat Jugosllave (Komisioni Evropian, 2009⁴⁷).

Sa i përket mbulimit të asaj pjesë të popullatës që jeton me më pak të ardhura, Shqipëria mbulon 28% të tyre me NE, ndërsa Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi

46 The Welfare State in Western Balkan Countries, fq. 15, aksesuar ne http://futureofthewelfarestate.org/wpcontent/uploads/2018/04/The_Welfare_State_in_Western_Balkan_Countries_Position_Paper.pdf

47 European Commission, 2009. Social Protection and Social Inclusion in the Western Balkans, Brussels, Belgium

mbulojnë respektivisht 31%, 22%, 26% dhe 15% (Programi i Kombeve të Bashkuara, 2016⁴⁸).

Sa i përket masës së NE në Shqipëri krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria është në nivel më të ulët krahasuar me Kosovën, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnje-Hercegovinën (UNICEF, 2019⁴⁹).

Strategjitë kryesore për të pasur përmirësim të politikës së NE dhe ndikim më të madh të saj në zbutjen e varfërisë sipas Matkovic (2017⁵⁰) janë:

- a) Shpenzime më të ulëta për NE dhe shënjestrim më i mirë i familjeve në nevojë. Kjo është një strategji që Shqipëria e ndoqi në aplikimin e reformës për NE. Në kushtet e buxheteve të vogla dhe të nivelit të borxhit publik, kjo duket se është një strategji e suksesshme për të mbuluar ata që realisht jetojnë në varfëri.
- b) Mbulimi universal me pagesa të mbrojtjes sociale. Strategjia e mbulimit universal do të thotë që fondi për mbrojtjen sociale duhet të mbulojë të gjitha nevojat e individëve dhe familjeve që kanë nevojë për t'u mbështetur, pavarësisht ekzistencës së programeve që targetojnë grupe apo aplikojnë kritere përjashtuese. Kjo strategji do të lehtësonte mbulimin me pagesa të NE edhe familje apo grupe si psh. familje të komunitetit Rom, që ndonjëherë nuk arrijnë të plotësojnë kriteret për përfitim nga skema.
- c) Investimi social është strategjia që priorizon investimin publik në ato reforma që sjellin zhvillim njerëzor. Shqipëria është vendi me investim më të ulët në Ballkanin Perëndimor sa i përket arsimit, kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale (Matkovic, 2017⁵¹), gjë që duhet rishikuar me prioritet nga qeveria në të ardhmen.
- d) Strategjitë parandaluese janë ato strategji që investojnë në politika që ndalojnë individët dhe familjet që të bien në varfëri, dy më të rëndësishmet janë politikat ekonomike dhe ato të punësimit. Forcimi i sindikatave dhe i rolit të tyre është një nga mjetet për të bërë presion për politika të duhura ekonomike dhe punësimi.
- e) Rritja e efikasitetit⁵² të strukturave shtetërore. Shqipëria me asistencën e Bankës Botërore gjatë reformës për NE, përmirësoi efikasitetin e strukturave dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për të administruar skemën. Por, ky përmirësim u verifikua vetëm sa i përket mosrritjes së kostove administrative, dhe nuk është vlerësuar në raport me qëllimin e reformës dhe të skemës, që është zbutja e varfërisë.

48 United Nations Development Programme, 2016. Inequalities and human development in Western Balkans aksesuar në <https://www.undp.org/content/dam/rbec/docs/undp-rbec-western-balkans-infographic.pdf>

49 UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar në <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

50 Matkovic, G. 2017. The Welfare state in Western Balkan Countries Challenges and Options, aksesuar në https://www.researchgate.net/publication/336852345_The_welfare_state_in_Western_Balkan_countries_Challenges_and_options

51 Po aty

52 Efikasiteti matet në raport me qëllimin e programit. Nëse programi synon që të zbusë varfërinë, atëherë efikasiteti vlerësohet nga transfertat për NE si dhe rezultatet në nivelin e varfërisë para dhe pas transfertave (Komisioni Evropian, 2016, fq.7)

3.2.1 Rasti i Kroacisë (vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor, anëtar i Bashkimit Evropian)

Kroacia e ka të parashikuar garantimin e minimumit jetik dhe pagesën që jep në formën e ndihmës ekonomike e quan pagesë për garantimin e minimumit jetik, duke e bërë të qartë qëllimin e politikës.

Kategoritë që mund të marrin pagesën për minimumin jetik janë⁵³: individë dhe familje. Në kategorinë individë përfshihen: individ beqar i/e paaftë për punë dhe individ beqar i/e aftë për punë/prind i vetëm. Në kategorinë familje përfshihen: i/e rritur, fëmijë deri në 18 vjeç, prind i vetëm, fëmijë i një prindi të vetëm/i një familjeje me një prind.

Përcaktimi i kategorive që mund të marrin një pagesë të tillë është i qartë, i thjeshtë dhe përfshirës edhe i nënkategorive të tjera si psh. viktimat e dhunës në familje apo nënkategori të tjera.

Pagesat për individët dhe familjet⁵⁴ sipas kategorive që parashikohen në legjislacionin kroat tregohen në Tabelën 1. më poshtë:

Tabela 1. Kategoritë dhe masa e pagesës të minimumit jetik në Kroaci

| Kategoritë | Masa e pagesës |
|---|----------------|
| 1) Individ | |
| Individ beqar i/e paaftë për punë | 123 EURO |
| Individbeqari/e aftëpërpunë/prindivetëm | 107 EURO |
| 2) Familje⁵⁴ | |
| I/e rritur | 64 EURO |
| Fëmijë derinë 18 vjeç | 43 EURO |
| Prind i vetëm | 107 EURO |
| Fëmijë i një prindi të vetëm/I një familjeje me një prind | 59 EURO |

Burimi: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1104&langId=en&intPagId=4464>

Minimumi jetik është përcaktim i bërë në Ligjin “Për Mirëqënien Sociale”⁵⁶, 2013 dhe garantimi i tij konsiderohet në ligj (neni 26) si një e drejtë. Në ligj përcaktohen nevojat bazë të individit ku përfshihen: ushqimi, strehimi, veshmbathje, element të përdorimit personal. Nevojave bazë për fëmijët dhe të rinjtë, në këtë përcaktim, ju shtohen si nevoja bazë edhe nevojat e zhvillimit,

53 <https://welcomm-europe.eu/croatia/welfare>

54 <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1104&langId=en&intPagId=4464>

55 Në rastin e familjes mblidhet masa e pagesës për secilin anëtar/e (shpjegim i autorëve)

56 https://digarhiv.gov.hr/arhiva/263/111934/narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2013_12_157_3289.html

rritjes dhe arsimit. Nevojat bazë për individët apo fëmijët me aftësi të kufizuara përcaktohen në ligjin specifik për aftësinë e kufizuar. Masa e minimumit jetik përcaktohet me vendim qeverie dhe indekskohet çdo vit në varësi të inflacionit. Të gjithë përfituesit e pagesës së minimumit jetik mund të përfitojnë nga shërbimet e tjera si psh: strehimi social, kompesimi për energjinë, etj.

3.2.2 Rasti i Maqedonisë së Veriut

Maqedonia e Veriut, ishte një nga vendet që për shumë vite pati rënie në transfertën për asistencën sociale prej 2001-2010⁵⁷, masa e ndihmës ekonomike ishte shumë e vogël dhe nuk mbulonte nevojat bazë të individëve dhe familjeve që jetonin në varfëri⁵⁸.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zbutjen e Varfërisë dhe Përrjashtimit Social 2010-2020⁵⁹, në vitin 2019, Maqedonia e Veriut miratoi ligjin e ri “Për Mbrojtjen Sociale” nëpërmjet të cilit bëri rregullimin ligjor të problematikave të hasura në sistemin e mbrojtjes sociale.

Në këtë ligj, u përkufizua minimumi jetik dhe u përcaktua se pagesa duhet të garantojë këtë minimum për të gjithë individët dhe familjet që jetojnë nën një nivel të caktuar të ardhurash. Marrja e pagesës për individët dhe familjet që jetojnë nën minimumin jetik, konsiderohet si e drejtë dhe sistemi i asistencës financiare nuk mund të përjashtojë individë apo familje nga kjo skemë. Përfitimi nga skema e asistencës financiare bën të mundur që individët apo familjet në këtë skemë të përfitojnë kompesim të energjisë për muajt Tetor-Mars dhe gjithashtu të marrin shërbime të tjera sociale.

Ligji i ri ruan jokushtëzimin dhe integron pagesat financiare me shërbimet e ofruara sociale. Në një raport të fundit të UNICEF (2020) vlerësohet se kategorizimi i bërë nga ligji ka lehtësuar përfitimet për personat me aftësi të kufizuar, fëmijët dhe familjet⁶⁰.

3.3 Përfundime dhe Rekomandime

Përfundime

Megjithë përpjekjet e qeverisë shqiptare për të reformuar sistemin e mbrojtjes sociale, mungon përkufizimi i minimumit jetik në legjislativën për mbrojtjen sociale, gjë që ndikon në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre.

57 Martkovic, G. 2017 The Welfare State in Western Balkan Countries-Challenges and Options

58 UNICEF 2018-Social Protection in North Macedonia Policy Paper

59 National Strategy for Reduction of Poverty and Social Exclusion 2010-2020 (revised), Ministry of Labor and Social Policy of the Republic of Macedonia (Skopje, 2013), http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/revidirana_str_siromastija.pdf

60 Analiza e gjendjes së grave dhe fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, fq.30, aksesuar ne https://www.unicef.org/northmacedonia/media/5336/file/Sit_Small_Women%20and%20Children_AL.pdf

Sipas vlerësimeve të deritanishme, masa e NE-së nuk ka pësuar rritje pas reformës. Masa e NE nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për ushqimin por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor për individët dhe familjet kur ata kanë nevojë.

Fëmijët dhe familjet e mëdha janë më të varfërat dhe grupet më të rrezikuara për të rënë në varfëri. Megjithë vëmendjen e rritur dhe ndryshimin e masës së NE për këto grupe, ky ndryshim ka qënë minimal dhe pa ndikim për daljen e tyre nga varfëria.

Kategorizimi, që bëhet për individët dhe familjet që mund të përfitojnë NE, në legjislacionin për NE dhe përfitimin e saj është shumë i detajuar duke krijuar mundësi që individë apo familje të caktuara të mos përfitojnë nga skema.

Investimet në politika të tjera, si politika e arsimimit, shëndetit apo punësimit që konsiderohen si politikat që ndikojnë më shumë në zbutjen e varfërisë dhe daljen nga varfëria, vazhdojnë të mbeten të ulëta.

Rekomandime

Të ndryshohet Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të përfshihet si dispozitë e veçantë perkufizimi i minimumit jetik.

Përlllogaritja e minimumit jetik dhe masa e tij duhet të jetë bazë për masën e NE dhe pagesën për Aftësinë e Kufizuar. Rritja e pagesës së NE është e nevojshme që bëhet dhe të reflektojë nevojat e individëve dhe familjeve jo vetëm për ushqim por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor.

Të thjeshtëzohet kategorizimi i individëve dhe familjeve që mund të përfitojnë nga skema e NE duke synuar mospërrjashtimin e kategorive apo nënkategorive.

Të vlerësohen përfitimi i shërbimeve shtesë pa pagesë ose minimumit të një kuote për shërbimet bazike për këta qytetarë.

4. Minimumi jetik në perspektivën ekonomike

4.1 Kuadri ekonomik dhe minimumi jetik

Tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia gjatë vitit 2020 kanë patur efekte negative të rëndësishme mbi ekonominë shqiptare. FMN⁶¹ dhe BB⁶² parashikojnë një recesion prej 8.5% në 2020, ndërsa rritja ekonomike parashikohet të jetë e moderuar në 5% për 2021 dhe 3.9% në 2022. Nga ana tjetër FMN⁶³ ka observuar se ekonomisë shqiptare i kanë munguar investimet pro-rritjes nga burime publike, ndërsa vendi ka një nivel të ulët të investimeve të huaja direkte në ekonomi.

Situata ekonomike në vendet e Bashkimit European gjithashtu do të ndikojë fort në aftësinë e ekonomisë shqiptare për t'u rimëkëmbur në vitet në vijim, kjo për arsye të ekspozimit të lartë që ka vendi ndaj ekonomive të BE sidomos atyre italiane dhe greke. Eksportet shqiptare drejt ketyre vendeve të cilat raportohen me një rënie prej -13 %⁶⁴ në 2020 - do ndikohen më tej nga ecuria e tyre ekonomike, çka e shton paqartësinë për rimëkëmbje në 2021 e në vijim.

Rritja e kreditimit në fund të vitit 2019⁶⁵ pas shumë vitesh stanjacion nuk ka arritur të përkthehet në rritje ekonomike që krijon punësim dhe të ardhura. Nga ana tjetër, struktura e shoqërive dhe fermës shqiptare mbetet tejet e fragmentuar – mbi 90% e bizneseve janë të vogla, ndërsa madhësia mesatare e fermës është 1.3 ha – çka demonstroi një bazë të dobët për të arritur një rimëkëmbje ekonomike të shpejtë e të qëndrueshme. Kompozimi i ekonomisë gjithashtu – ku bujqësia e prapambetur përfaqëson rreth 20% dhe turizmi, një nga sektorët më të goditur në 2020 ka një peshë të ngjashme në produktin e përgjithshëm kombëtar – nuk duket se mund të përshpejtojë rimëkëmbjen ekonomike të vendit, sidomos kur masat anti-covid pritet të vijojnë së paku edhe në vitin 2021.

Konsumi privat pritet të ruajë rolin e vet shumë të rëndësishëm dhe primar në rritjen ekonomike në periudhë afatmesme; por në kushtet e rritjes së papunësisë në 2020, ky konsum i pambeshtetur

61 Deklarata e fundit e FMN- <https://www.imf.org/en/News/SearchNews#sort=%40imfdate%20descending>

62 World Bank Western Balkans Regular Economic Report Update Fall 2020- <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

63 IMF Mission statement November 26th 2019-; <https://www.imf.org/en/News/Articles/2019/11/26/mcs11262019-albania-staff-concluding-statement-of-the-2019-article-iv-mission>

64 INSTAT, Tregtia e Jashtme e Mallrave, Dhjetor 2020 <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/publikimet/2020/tregtia-e-jashtme-dhjetor-2020/>

65 EC Albania Progress Report 2020; https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

nga rritja e aktivitetit ekonomik dhe punësimin në vend do jetë i varur kryesisht nga remitancat dhe kursimet e qytetarëve.

Varfëria pritet të rritet në 2020 dhe në periudhën afatmesme, kohë gjatë së cilës Shqipërisë i duhet të fillojë një program të rimëkëmbjes ekonomike. Varfëria monetare dhe materiale që u rrit në zonat e prekura nga tërmeti në 2019 pritet të shtohet edhe më përgjatë 2020, me zgjatjen e pandemisë, e cila do të sjellë efekte negative në ekonomi e “cila pritet të kontraktohet fort gjatë vitit 2020 me projeksionin për rimëkëmbje gjatë viteve 2021 dhe 2022”⁶⁶ “Dobësimi i turizmit, remitancave, kërkesës nga jashtë, Investimeve të Huaja Direkte më të vogla, dhe zvogëlimit të hapësirës fiskale⁶⁷” do vijonë të ndikojnë negativisht në ekonominë e shqiptarëve edhe në periudhën afatmesme. Numri i familjeve në Ndhmë Ekonomike në vitin 2019 ishte 61,542⁶⁸ duke shënuar një rritje prej 5% përkundrejt vitit 2018, ndërsa pritet që ky numër të jetë edhe më i lartë për vitin 2020. Numri i të varfërve është rritur; norma e varfërisë në vitin 2020 mendohet të jetë në nivelin 41.5%⁶⁹ - njerëz që jetojnë me 5.5 dollarë në ditë – duke shënuar një rritje prej 5.9 pikë përqindje kundrejt një viti më parë.

Një situatë e tillë makroekonomike, e brendshme dhe e jashtme, pritet të ngadalësojë të gjithë treguesit që lidhen nivelin e jetesës, punësimin, të ardhura nga njëra anë dhe rrisë nevojat për të siguruar një minimum të ardhurash për shtresat e varfëra në nevojë.

Edhe pse pritet që në periudhën afatmesme numri i njerëzve të varfër të shtohet, sikundër dhe numri i personave në rrezik për të rënë në varfëri, Shqipëria vijon të mos ketë një qasje zyrtare ndaj minimumit jetik. Numri i personave që rrezikojnë të bien në varfëri sipas INSTAT në vitin 2018 ka qenë 671,000 persona duke vendosur si kufi të këtij rreziku shumën prej 16,742 Lek. Minimumi jetik i kalkuluar nga AP në vitin 2016 nuk ka shërbyer të udhëzojë as kalkulimin e Ndhmës Ekonomike që përfitohet nga personat dhe familjet shqiptare, dhe as Pagën Minimale, e cila u rrit së fundmi nga autoritetet në nivelin e 30.000 Lek.

4.2 Politikat sociale dhe Minimumi Jetik në vendet e Bashkimit Europian

Në përgjigje të krizës globale financiare të vitit 2008, Bashkimi Europian miratoi në vitin 2010 Strategjinë Europa 2020. Kjo strategji synon reduktimin e numrit të njerëzve që rrezikojnë të bien në varfëri ose në përjashtim social me rreth 20 milion persona në vitin 2020 krahasuar me nivelin e vitit 2008. Numri i njerëzve që rrezikojnë të binin në varfëri në Bashkimin Europian filloi të rritej në vitin 2009 si rezultat i krizës globale financiare

66 Albania : First Post-Program Monitoring-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for Albania, November 30, 2020

67 Albania : First Post-Program Monitoring-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for Albania, November 30, 2020

68 VKM Nr. 882, datë 24.12. 2019, “Për Mekanizmin e Bashkëndimit Institucional të Punës për Referimin për Punësim të Individëve dhe Anëtarëve në Moshë Aktive Pune të Familjeve Përfituese të Ndhmës Ekonomike.”

69 World Bank Western Balkans Regular Economic Report Update Fall 2020- <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

të vitit 2008. Në vitin 2018, rreth 109.9 milion persona ishin në rrezik varfërie në Bashkimin Europian, ose 6.2 milion më pak se në 2008. Sidoqoftë, rreth 21.8% e popullsisë së BE mbeten të rrezikuar të bien në varfëri në 2018, ose 13.8 milion më shumë sesa objektivi i strategjisë për vitin 2020.

Tabela 2. Indikatorët që monitorohen në kuadër të strategjisë Europa 2020⁷⁰

| Çështja | Indikatori | 2008 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | Target |
|--|--|-------|-------|-------|-------|-------|------|--------|
| Varfëria dhe perjashtimi social | Njerëz në rrezik varfërie ose përjashtimi social (në mln njerëz) | 116.1 | 117.9 | 116.9 | 111.9 | 109.9 | na | 96.1 |
| | Njerëz në rrezik varfërie ose përjashtimi social (në % të popullsisë) | 23.7 | 23.8 | 23.5 | 22.4 | 21.8 | na | |
| | Njerëz që jetojnë në famile me një intensitet pune të ulët (% e popullsisë të moshës 0-59 vjec) | 9.2 | 10.7 | 10.5 | 9.5 | 8.7 | na | |
| | Njerëz në rrezik varfërie pas tranfertave sociale (në % të popullsisë) | 16.6 | 17.3 | 17.3 | 16.9 | 17.1 | na | |
| | Njerëz pa burime materiale (në % të popullsisë) | 8.5 | 8.1 | 7.5 | 6.6 | 5.9 | na | |

70 Burimi: Europe 2020 Headline indicators https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Europe_2020_headline_indicators#People_at_risk_of_poverty_or_social_exclusion

Arritja e objektivit strategjik dukshëm kërkon përpjekje më të mëdha në tri drejtime kryesore: në pamjaftueshmërinë e transfertave sociale; intensitetin e ulët të punës; dhe përjashtimin social. Sfida e uljes së numrit të njerëzve në rrezik varfërie dhe përjashtimi social në Bashkimin Europian bëhet aktualisht shumë më e vështirë për shkak të pandemisë së Covid-19, dhe efekteve negative të saj në ekonominë dhe shoqërinë europiane. Natyrshëm, për të arritur objektivat e strategjisë Europa 2020, por edhe për t'u përballur me situatën aktuale që po kalon e gjithë bota, është e pritshme që garantimi i minimumit jetik për njerëzit që rrezikojnë të bien në varfëri dhe përjashtim social në vendet e BE të marrë një rol qëndror në politikë-bërjen e BE në vitet në vijim.

4.3 Minimumi Jetik në vendet e Bashkimit Europian

Skemat e të ardhurave minimale në Bashkimin Europian kuptohen si skema të mbështetjes së të ardhurave për njerëzit në moshë pune (në punë ose jo) të cilat garantojnë mbrojtje sociale për ata që nuk kualifikohen për pagesa të sigurimeve shoqërore, ose për ata të cilëve u ka mbaruar e drejta për të përfituar nga këto pagesa. Këto skema të të ardhurave minimale janë mburoja e fundit, përmes të cilave synohet parandalimi i varfërisë ekstreme dhe sigurimi i një standardi minimal jetese të denjë për individët dhe personat në ngarkim të tyre, kur ata nuk kanë asnjë mjet tjetër si mbështetje financiare, ose ato që kanë janë të pamjaftueshme.

Shumica e vendeve të BE kanë një mekanizëm të qartë për përcaktimin e nivelit të pagesave i cili bazohet në një grup treguesish të specifikuar qartë (shih Tabelën 3) dhe normalisht merr parasysh përbërjen e familjes. Qasja më e zakonshme lidhet me vendosjen e standardeve minimale të jetesës (p.sh. përmes çmimeve, shportës së mallrave, kufirit absolut të varfërisë, buxheteve referuese).

Përdoren edhe disa metoda të tjera. Për shembull, në Zvicër përfitimet e rekomanduara synojnë të pasqyrojnë të ardhurat e disponueshme të 10% të familjeve më të varfra. Në Gjermani, niveli i përfitimit zbritet nga shpenzimet e grupeve me të ardhura më të ulta, të matura çdo pesë vjet me anë të Modelit të Të Ardhurave dhe Konsumit. Në Finlandë, përfitimet Themelore të Asistencës Sociale janë të lidhura me indeksin e kostos së jetesës, por niveli vendoset nga Parlamenti. Çdo 4 vjet, një vlerësim sugjeron se cilat ndryshime mund të konsiderohen, por kjo nuk çon domosdoshmërisht në një ndryshim në nivelet e përfitimeve - d.m.th., nivelet nuk rregullohen automatikisht në bazë të vlerësimit. U takon politikanëve të vendosin nëse duhet të ketë një "rritje të nivelit" përveç rritjeve automatike për shkak të ndryshimeve në indeksin e kostos së jetesës. Në Luksemburg, niveli i skemës së Minimumit të të Ardhurave (MA) u krijua fillimisht me ligj, duke marrë parasysh (por jo i lidhur zyrtarisht me) nivelin e minimumeve të tjera ekzistuese të mbrojtjes sociale, të tilla si paga minimale, përfitimet e papunësisë dhe pensioni minimal. Në Portugali, shuma për të Ardhurat e Integritit Social (RSI) përcaktohet nga një Urdhër i miratuar nga Ministria e Solidaritetit dhe Sigurimeve Shoqërore dhe korrespondon me një përqindje të Indeksit të Mbështetjes Sociale. Në Spanjë, shumica e rajoneve krijojnë përfitime të MA si përqindje e IPREM - Indikatori Publik i të Ardhurave për Qëllime të Shumëfishta, i cili është një tregues i krijuar relativisht vonë - në 2004, me qëllimin e përdorimit si një referencë për të ardhurat për një shumëllojshmëri programesh të mbrojtjes sociale. Supozohet të indeksohet

çdo vit në buxhetin e shtetit, megjithëse është ngrirë që nga viti 2010. Në Itali, situata është mjaft e larmishme – ka 10-të skema të MA, të cilat përdorin pragje të ndryshme të të ardhurave të familjeve, dhe që aplikohen bazuar në numrin e përbërësve të familjes. Gjashtë skema të MA përdorin sistemin kombëtar të testimit të mjeteve (ISEE, indeksi i situatës ekonomike të barazuar), i cili shërben për të ofruar disa përfitime sociale (p.sh. përjashtimi nga kostot ose ulja e tarifave për shërbimet shëndetësore, çerdhet dhe objektet e kujdesit për fëmijët, librat shkollorë, qiraja e shtëpisë, etj). Skemat e tjera të MA-së përdorin treguesit rajonalë/krahinorë (Trento dhe Val d’Aosta), buxhetet mujore për të përmbushur nevojat themelore (Bolzano) dhe pagesën mujore të ndihmës sociale për personat në moshë pensioni (Siçili).

Tabela 3: Mekanizmat e vendosjes së minimumit të të ardhurave në vendet e BE⁷¹

| Vënde në të cilat ekziston një mekanizëm i cili vendos nivelin e pagesave të bazuar në indikator të specifikuar shumë qartë. Mekanizmi bazohet në : | | | | Vënde në të cilat nuk ekziston një mekanizëm i qartë dhe niveli i përfitimit përcaktohet në mënyre subjektive dhe arbitrare |
|---|---|--|---|---|
| Mediana / Të ardhurat mesatare ose përqindja e tyre (p.sh. kufiri relativ i varfërisë kombëtare) | Standarti i jetesës (çmimet, niveli i varfërisë absolute, shporta e të mirave | Paga minimale | Të tjera | |
| IT (BA/FG/MO/NSC/PU/SA/ SI/ TN/VA) | CY CZ FI (çdo kater vjet) IS IT (BZ) LI MT PL SE SI | ES (Andalusia, Navarre, vendet Baske, Melilla) FR NL | CH, DE, ES, (shumica e rajoneve) FI (BSA*) LU PT RS UK | AT BE BG DK (por niveli i përfitimit nuk vendoset arbitrarisht) EE EL FR HR HU IE LT LV, MK NO RO, SK |

Burimi: Skemat e të ardhurave Minimale në Europë, Komisioni Europian

Në shumë vende të Europës niveli i minimumit të të ardhurave shpeshherë përcaktohet si një vendim politik më shumë sesa i bazuar në evidence shkencore. Rregullsia e rishikimit të minimumit jetik varion mes vendeve, proceseve dhe kompromiseve politike, dhe ndryshimi në nivelet e MA të vendeve të Bashkimit Europian lidhet në shumicën e rasteve me rritjen e nivelit të jetesës dhe rritjen e inflacionit. Në dy tabelat e mëposhtme jepen minimum jetik për njësi familjare – në shumë vende të BE legjislativi, metodologjitë e përdorura për llogaritjen e MA mbajnë parasysh përbërjen familjare dhe për frymë.

71 Minimum income schemes in Europe 2015, European Commission, European Social Policy Network; <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=7882&furtherPubs=yes>

Tabela 4. Minimumi i të ardhurave për familje

| Vëndi/Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|--------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| BASHKIMI EUROPIAN | | | | | | | | | | |
| Belgjike | 2,044 | 2,101 | 2,129 | 2,256 | 2,279 | 2,274 | 2,341 | 2,387 | 2,487 | na |
| Danimarke | 2,695 | 2,829 | 2,854 | 2,882 | 2,925 | 2,978 | 3,010 | 3,085 | 3,161 | 3,225 |
| Gjermani | 1,974 | 2,000 | 2,058 | 2,056 | 2,072 | 2,170 | 2,234 | 2,302 | 2,385 | na |
| Irland | 2,154 | 2,071 | 2,063 | 2,085 | 2,118 | 2,271 | 2,367 | 2,402 | 2,617 | na |
| Greqi | 1,256 | 1,153 | 999 | 879 | 806 | 790 | 788 | 798 | 826 | 861 |
| Spanjë | 1,534 | 1,463 | 1,456 | 1,420 | 1,393 | 1,402 | 1,437 | 1,491 | 1,552 | 1,577 |
| Francë | 2,096 | 2,100 | 2,163 | 2,197 | 2,226 | 2,249 | 2,280 | 2,306 | 2,333 | na |
| Itali | 1,676 | 1,677 | 1,678 | 1,652 | 1,655 | 1,664 | 1,706 | 1,737 | 1,769 | na |
| Luksemburg | 3,395 | 3,417 | 3,442 | 3,497 | 3,604 | 3,703 | 3,551 | 3,788 | 4,228 | na |
| Hollandë | 2,131 | 2,133 | 2,159 | 2,188 | 2,194 | 2,236 | 2,387 | 2,474 | 2,522 | 2,572 |
| Austri | 2,211 | 2,254 | 2,290 | 2,318 | 2,437 | 2,442 | 2,488 | 2,599 | 2,643 | 2,702 |
| Portugali | 911 | 883 | 874 | 859 | 864 | 886 | 922 | 952 | 981 | 1,052 |
| Finland | 2,242 | 2,292 | 2,383 | 2,444 | 2,489 | 2,495 | 2,483 | 2,519 | 2,577 | 2,612 |
| Suedi | 1,984 | 2,266 | 2,504 | 2,667 | 2,713 | 2,657 | 2,642 | 2,664 | 2,682 | 2,570 |
| Letoni | 471 | 441 | 467 | 490 | 546 | 612 | 668 | 694 | 770 | 860 |
| Lituani | 423 | 405 | 455 | 493 | 506 | 544 | 593 | 644 | 724 | 797 |
| Estoni | 601 | 588 | 629 | 691 | 758 | 828 | 908 | 985 | 1,105 | 1,203 |
| Bullgari | 317 | 306 | 300 | 307 | 348 | 350 | 331 | 377 | 377 | 444 |
| Çeki | 741 | 782 | 818 | 808 | 800 | 779 | 823 | 870 | 954 | 1,050 |
| Slllovak | 642 | 662 | 727 | 707 | 715 | 728 | 730 | 754 | 784 | na |
| Hungari | 445 | 472 | 493 | 467 | 474 | 478 | 501 | 524 | 570 | 615 |
| Poloni | 463 | 528 | 531 | 542 | 560 | 583 | 618 | 624 | 690 | 748 |
| Rumani | 214 | 220 | 215 | 212 | 226 | 243 | 257 | 288 | 345 | 404 |
| Kroaci | 610 | 586 | 565 | 533 | 549 | 573 | 601 | 652 | 699 | 767 |
| Sllloveni | 1,232 | 1,260 | 1,273 | 1,245 | 1,251 | 1,295 | 1,294 | 1,335 | 1,391 | 1,477 |
| Malta | 1,096 | 1,141 | 1,202 | 1,265 | 1,345 | 1,423 | 1,430 | 1,525 | 1,552 | 1,612 |
| Qipro | 1,699 | 1,784 | 1,777 | 1,667 | 1,512 | 1,448 | 1,472 | 1,522 | 1,610 | 1,703 |

Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01/default/table

Tabela 5. Minimumi i të ardhurave për frymë ne vëndet e Bashkimit European

| Vëndi/Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|--------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| BASHKIMI EUROPIAN | | | | | | | | | | |
| Belgjike | 973 | 1,000 | 1,014 | 1,074 | 1,085 | 1,083 | 1,115 | 1,137 | 1,184 | na |
| Danimarke | 1,283 | 1,347 | 1,359 | 1,372 | 1,393 | 1,418 | 1,433 | 1,469 | 1,505 | 1,536 |
| Gjermani | 940 | 952 | 980 | 979 | 987 | 1,033 | 1,064 | 1,096 | 1,136 | na |
| Irland | 1,026 | 986 | 982 | 993 | 1,008 | 1,082 | 1,127 | 1,144 | 1,246 | na |
| Greqi | 598 | 549 | 476 | 419 | 384 | 376 | 375 | 380 | 393 | 410 |
| Spanjë | 730 | 697 | 693 | 676 | 663 | 668 | 684 | 710 | 739 | 751 |
| Francë | 998 | 1,000 | 1,030 | 1,046 | 1,060 | 1,071 | 1,086 | 1,098 | 1,111 | na |
| Itali | 798 | 799 | 799 | 787 | 788 | 792 | 812 | 827 | 842 | na |
| Luksemburg | 1,617 | 1,627 | 1,639 | 1,665 | 1,716 | 1,764 | 1,691 | 1,804 | 2,014 | na |
| Hollandë | 1,015 | 1,016 | 1,028 | 1,042 | 1,045 | 1,065 | 1,137 | 1,178 | 1,201 | 1,225 |
| Austri | 1,053 | 1,073 | 1,090 | 1,104 | 1,161 | 1,163 | 1,185 | 1,238 | 1,259 | 1,286 |
| Portugali | 434 | 421 | 416 | 409 | 411 | 422 | 439 | 454 | 467 | 501 |
| Finland | 1,067 | 1,091 | 1,135 | 1,164 | 1,185 | 1,188 | 1,183 | 1,199 | 1,227 | 1,244 |
| Suedi | 945 | 1,079 | 1,192 | 1,270 | 1,292 | 1,265 | 1,258 | 1,269 | 1,277 | 1,224 |
| Letoni | 224 | 210 | 223 | 233 | 260 | 291 | 318 | 330 | 367 | 409 |
| Lituani | 202 | 193 | 217 | 235 | 241 | 259 | 282 | 307 | 345 | 379 |
| Estoni | 286 | 280 | 299 | 329 | 361 | 394 | 432 | 469 | 526 | 573 |
| Bullgari | 151 | 146 | 143 | 146 | 166 | 167 | 158 | 180 | 180 | 211 |
| Çeki | 353 | 373 | 390 | 385 | 381 | 371 | 392 | 414 | 454 | 500 |
| Slovakia | 306 | 315 | 346 | 337 | 341 | 347 | 348 | 359 | 373 | na |
| Kroaci | 291 | 279 | 269 | 254 | 261 | 273 | 286 | 311 | 333 | 365 |
| Rumani | 102 | 105 | 102 | 101 | 108 | 116 | 122 | 137 | 164 | 193 |
| Sloveni | 587 | 600 | 606 | 593 | 596 | 617 | 616 | 636 | 662 | 703 |
| Qipro | 809 | 850 | 846 | 794 | 720 | 690 | 701 | 725 | 767 | 811 |
| Malta | 522 | 543 | 572 | 602 | 640 | 678 | 681 | 726 | 739 | 768 |
| Hungari | 212 | 225 | 235 | 223 | 226 | 228 | 238 | 249 | 271 | 293 |
| Poloni | 220 | 251 | 253 | 258 | 267 | 278 | 294 | 297 | 329 | 356 |

Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01/default/table

Nga të dhënat për minimumin jetik për frymë në Bashkimin European vërejmë se nivelin më të lartë për vitin 2018 e ka Luksemburgu me rreth 2,014 EUR për frymë e ndjekur nga Danimarka me 1,505 EUR për të njëjtin vit. Vendi i BE me nivelin më të ulët të këtij treguesi është Rumania, ky tregues regjistrohet të jetë 193 EUR në vitin 2019, duke shënuar një rritje me 17.7% kundrejt një viti më parë. Në nivele të ngjashme me Rumaninë është dhe Bullgaria ku ky minimum jetik është në nivelin e 211 EUR për vitin 2019. Vlen të vërehet se 5 vende të BE në vitet 2013-2015 kanë patur një kontraktim të minimumit jetik, duke reflektuar kështu vështirësitë ekonomike, dhe kufizimin e mundësive financiare që ato kanë përjetuar në këtë periudhë, për ta rimarrë rritjen në vijim siç reflektohet edhe tek niveli i minimumit jetik nga viti 2015 e më pas. Po ashtu është e rëndësishme të nënvizojmë se Spanja arriti në nivelet e vitit 2008 vetëm pas 8 vjetësh, ndërsa niveli i minimumit jetik që llogaritet në 410 EUR për Greqinë në vitin 2019 është ende 31% më i ulët se në vitin 2008.

Natyrshëm, diferencat e mëdha që vërehen mes vendeve të reja anëtare të BE dhe atyre fillestare përcjellin statet e ndryshme të zhvillimit ekonomik e social, si dhe historinë politike e ekonomike të këtyre vendeve që pas Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu ato përcjellin edhe veçoritë dhe qasjet e ndryshme politike, ekonomike, sociale por edhe metodologjike, ndaj kalkulimit të minimumit jetik, dhe administrimit të tij në nivel qendror dhe lokal, duke krijuar një larmi modelesh, të cilat sa i përket vendeve anëtare të reja të Bashkimit European si: Bullgaria, Kroacia, Malta, Sllovenia, Estoni, Hungaria, Rumania, Çekia, Lituania paraqiten në formë të përmbledhur në aneksin II të këtij raporti.

4.4 Minimumi Jetik në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një rritje të ngadaltë, qysh prej krizës financiare të vitit 2008. Ato mbeten vendet më të varfëra të Europës, me nivel të ulët të jetesës të dukshme kudo. Kjo situatë është përkeqësuar edhe më për shkak të recesionit së shkaktuar nga pandemia e Covid-19 që po kalon mbarë bota. Ky recesion ka përkeqësuar kushtet e tregut duke ndërprerë përmirësimet në kujdesin social, pasi përpara pandemisë Ballkani Perëndimor shënonte progres dhe rritje të të ardhurave. Kriza vlerësohet të ketë shtyrë në varfëri më shumë se 300,000 njerëz në Shqipëri, Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi. Me shumë se gjysma e ndërmarrjeve në vendet e BP u detyruan të mbyllen, të paktën përkohësisht duke duke humbur kështu të ardhurat dhe rritur papunësinë.

Në fakt, karakteristikë për Ballkanin perëndimor mbetet papunësia kronike, ndërsa shumë familje mbështeten tek transfertat buxhetore dhe remitancat. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor udhëhiqet kryesisht nga konsumi, i cili mbështetet nga remitancat, borxhi dhe zhvillimi i pasurive të patundshme. Ecuria e rimëkëmbjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor do të ndikohet nga shpejtësia me të cilën ekonomia e BE do fillojë të lëvizë pas krizës së pandemisë. Sfidat me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor janë ristrukturimi i ekonomisë, rritja e produktivitetit, ulja e informalitetit, rritja e punësimit dhe krijimi i mundësive që shtresat e varfëra të mund të përmirësojnë nivelin e jetesës.

Tabela 6: Të dhënat kryesore për vendet e Ballkanit Perëndimor

| | Popullsia (million) | Rritja e GDP | PBB për frymë Eur | Papunësia |
|-------------------------------|------------------------|--------------|----------------------|-----------|
| EU-27 | 446.8 | 2.1 | 27,980 | 3.2 |
| Shqipëri | 2.9 | 4.1 | 4,470 | 11.4 |
| Bosnia Herzegovina | 3.5 | 3.1 | 4,897 | 15.2 |
| Kosovë | 1.8 | 3.8 | 3,835 | 17.2 |
| Maqedonia e Veriut | 2.1 | 2.7 | 5,459 | 15.5 |
| Mal i Zi | 0.6 | 5.1 | 7,490 | 11.4 |
| Serbi | 7.0 | 4.4 | 6,593 | 7.6 |

Burimi: Te dhena kryesore per vendet ne zgjerim 2020 -Eurostat⁷²

Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të krijojnë një sistem të mbrojtjes sociale në gjendje të arrijë objektivin për të mbrojtur të vuajturit pa penguar punësimin dhe të rritjen e produktivitetit - pasi sistemi aktual i mbrojtjes sociale jo rrallë dekurajon punësimin dhe pjesëmarrjen në forcat e punës. Konvergjenca me Bashkimin Europian është e ulët, dhe çdo rritje apo përmirësim në nivelin e mbështetjes sociale kërkon më së pari rritjen e punësimit – ndihma ekonomike, transfertat e tjera sociale, apo dhe minimumi jetik do të duhej të mos konsideroheshin si pengesë në këtë proces.

Nivelet e përcaktuar si minimum jetik në vendet e Ballkanit Perëndimor reflektojnë distancën në zhvillimin ekonomik përkundër vendeve të Bashkimit Europian. Mali i Zi shfaq vlerën më të lartë të përkufizuar si minimum jetik, ndjekur nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Nuk ka të dhëna për Bosnjen dhe Herzegovinën, Shqipërinë dhe Kosovën që të mund të bënim një krahasim mes tyre. Shifrat në dispozicion konfirmojnë rritjen e vazhdueshme, por shumë të vogël të minimumit jetik në Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.

Tabela 7: Minimumi jetik për njësi familjare në vendet e Ballkanit Perëndimor

| Ballkani Perëndimor | | | | | | | | | | |
|-------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Vëndi/Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
| Mal i Zi | na | na | na | 311 | 318 | 329 | 336 | 367 | na | na |
| Maqedonia e Veriut | na | na | 191 | 200 | 204 | 223 | 235 | 256 | 276 | na |
| Serbi | na | na | na | 254 | 255 | 250 | 255 | 266 | 288 | na |

Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/ILC_LI01/default/table

Tabela 8: Minimumi jetik për frymë në vendet e Ballkanit Perëndimor

| Ballkani Perëndimor | | | | | | | | | | |
|---------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Vëndi/Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
| Mal i Zi | na | na | Na | 148 | 152 | 157 | 160 | 175 | na | na |
